

2025



BAROMETRI I SIGURISË SHQIPËRI ANKETË KOMBËTARE

CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

**Friedrich
Ebert** 
Stiftung

Barometri i Sigurisë 2025

Anketë Kombëtare 2025 - Shqipëri

Autorë

Arjan Dyrmishi

Metodologjist

Eduard Zaloshnja

Përpunimi i të dhënave

Alaattin OZDE, *Albelite Design*

Parathënie

Katharina Hofmann, *Përfaqësuese Rezidente, Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra Tiranë*

Editimi

Mirsada Hallunaj

Dizajni Grafik

Ergys Temali

Imazhet

Freepik.com

Intervistuesit në terren

Aket Domeri, Anila Gjini, Ariola Mulaj, Arjana Kola, Besiana Paftali, Caush Idrizi, Denisa Elezi, Diana Minarolli, Elida Balla, Elma Saraci, Endri Habip, Eneida Sokolli, Irena Ilambi, Irena Dervishi, Irma Coku, Joana Meco, Leonora Celaj, Liljana Gjinali, Lindita Pirani, Mirjana Beqiraj (Haxhi), Qazim Palushi, Rajmonda Nushi, Rovenë Gjyshi, Sami Mecollari, Shpresa Faria, Sonila Prushi, Vjollca Gjini

Mirënjohje

Ky botim i Barometrit të Sigurisë në Shqipëri u bë i mundur falë mbështetjes së Fondacionit Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra Tiranë.

Të drejtat e autorit

© Të gjitha të drejtat i përkasin Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes dhe Friedrich-Ebert-Stiftung. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në ndonjë formë apo mjet – elektronik, mekanik apo tjetër – pa cituar Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes.

CSDG, FES, Shtator 2025

Parakusht

Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Fondacionit Friedrich-Ebert-Stiftung (FES). Analizat e paraqitura pasqyrojnë vetëm perceptimet e qytetarëve dhe nuk përbëjnë një vlerësim përfundimtar të çështjeve të trajtuara.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	7
HYRJE	9
METODOLOGJIA.....	11
Pyetësi.....	11
Kampionimi.....	11
Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave.....	12
Analizimi i të dhënave	12
Sfidat	13
GJETJE KRYESORE.....	14
ANALIZË E DETAJUAR E REZULTATEVE TË ANKETËS.....	20
INFORMACION DEMOGRAFIK.....	20
KËRCËNIMET NDAJ SIGURISË KOMBËTARE.....	24
MARRËDHËNIET RAJONALE.....	27
Pengesë për pajtimin.....	28
Kërcënimet e perceptuara sipas vendeve.....	29
GJEOPOLITIKA DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE.....	32
Influenca gjeopolitike.....	32
Përdorimi i ndikimit global	33
Çështjet globale dhe prioritetet e politikës së jashtme	34
Marrëdhëniet me të mira me shtetet	35
Marrëdhëniet transatlantike dhe organizatat ndërkombëtare	38
ANËTARËSIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN.....	43
KRIMI I ORGANIZUAR: PERCEPTIME DHE QËNDRIME.....	49
Serioziteti dhe aktivitetet e krimit të organizuar	49
Aktivitetet e Krimit të Organizuar.....	52
Aktiviteti i kultivimit të kanabisit.....	53
Faktorët dhe shkaqet kryesore që kontribuojnë në krimin e organizuar	56
Faktorët socialë.....	57
Faktorët institucional	59
Krimi i organizuar dhe zgjedhjet e 11 Majit 2025.....	75
VIKTIMIZIMI DHE RAPORTIMI I KRIMIT	100
Shtojca 1 – Shpërndarja gjeografike	107
Shtojca 2 – Shpërndarja sipas bashkive	108

LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Evropian
CSDG	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
FES	Friedrich-Ebert-Stiftung
INSTAT	Instituti i Statistikave
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
NUTS 3	Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat – Niveli 3
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SPAK	Struktura Speciale Anti-Korrupsion
STATA	Software i analizave statistikore
UN	Kombet e Bashkuara
USA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

PARATHËNIE

Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) po punon në mbarë botën për mbrojtjen dhe promovimin e demokracisë sociale. Fatmirësisht, Evropa ende mbetet rajoni më paqësor në botë – megjithëse sulmi ndaj Ukrainës ndryshoi në mënyrë thellësisht negative perspektivën evropiane dhe ballkanike mbi kërcënimet e ardhshme. Përveç të menduarit tradicional mbi sigurinë, duhet të pranojmë se forma të tjera dhune, të shkaktuara nga korrupsioni apo krimi i organizuar, gjithashtu kërcënojnë shtetet dhe demokracinë. Kjo është arsyeja pse ky edicion i Barometrit të Sigurisë fokusohet tek perceptimet e qytetarëve mbi kërcënimet e brendshme dhe ndikimin e tyre në mirëqeverisjen dhe sigurinë njerëzore.

Konfliktet e brendshme, që mund të shkaktohen nga grupet kriminale, minojnë aftësinë e shteteve për të qeverisur dhe për të zbatuar parimet e shtetësisë moderne: kontrollin mbi territorin (për prodhim apo tregtim), sigurinë fizike dhe emocionale të qytetarëve, një sistem gjyqësor funksional dhe monopolin mbi përdorimin legjitim të forcës. Trafiku i drogës, tregtia e armëve dhe trafiku i qenieve njerëzore janë të përhapura në Ballkan, në Evropë dhe në mbarë botën – duke prekur veçanërisht vendet me dalje në tregtinë detare. Ndërkohë, kërkesa për kokainë po rritet në vendet më të pasura, dhe tregtia globale ndjek logjikën e tregut të ofertës dhe kërkesës.

Është e qartë se krimi i organizuar ka adoptuar mekanizmat e ekonomisë së globalizuar: një shkallë të lartë fleksibiliteti, aftësi për t’iu përshtatur ndryshimeve të tregut dhe përdorimin e segmenteve më të brishta të shoqërisë për qëllimet e veta. Kombet tashmë të dobësuar në mënyrë strukturore janë vënë nën presion serioz nga rritja e këtij fenomeni, ndërkohë që krimi i organizuar fiton gjithnjë e më shumë akses në politikë. Kjo krijon një spirale mosbesimi, duke minuar besimin e qytetarëve tek institucionet shtetërore.

Krimi i organizuar ka fituar pushtetin e tij nga dobësia e autoriteteve ligjore e kushtetuese dhe përmes infiltrimit të sistemit politik. Solidariteti, barazia dhe fuqizimi i të përjashtuarve nuk janë të integruara në qeverisjen e krimit, i cili bazohet më tepër mbi lakminë dhe frikën. Por të përjashtuarit bëhen pjesë e strukturave që ndërtojnë grupet e organizuara, të inkuorpuara në një “kulturë mbrojtjeje” që zëvendëson funksionet sociale dhe mbrojtëse të shtetit.

Politikat neoliberale kanë zgjeruar hapësira të paqeverisura, të cilat janë pushtuar lehtësisht nga rrjetet ilegale. Format e paligjshme të grupeve të krimit të organizuar janë ristrukturuar në njësi fleksibël që operojnë ndërkombëtarisht, të lidhura me njëra-tjetrën si përshtatje ndaj globalizimit dhe ekonomisë globale.

Roli i krimit të organizuar në erozionin e qeverisjes demokratike shënohet nga zëvendësimi i politikave sociale nga aktorë jo-shtetërorë, korrupsioni i aktorëve politikë dhe financimi i paligjshëm i fushatave elektorale. Faktorët më të rëndësishëm për të mbajtur gjallë një sistem kriminal janë: gjenerimi i të ardhurave nga tregtia e drogës dhe trafiku i qenieve njerëzore, pastrimi i parave, furnizimi me armë dhe intensifikimi i pushtetit politik përmes korrupsionit

dhe pandëshkueshmërisë. Forca e institucioneve përcakton nivelin e cënueshmërisë ndaj korrupsionit.

Përveç niveleve ekonomike dhe politike, edhe niveli social duhet të integrohet në kërkimin e qasjeve të reja për të luftuar fenomenin. Shkalla e krimit të organizuar lidhet drejtpërdrejt me dështimin e mirëqenies materiale. Pabarazia socio-ekonomike dhe mosbesimi në politikë janë pasojë e mungesës së një politike sociale gjithëpërfshirëse. Zgjerimi i hendekut social në mbarë botën është i dukshëm në Amerikën Latine, por i pranishëm edhe në shumicën e vendeve evropiane dhe ballkanike. Veçanërisht të rinjtë e përfshirë në dhunë të armatosur demonstrojnë dështimin për të integruar ata që nuk kanë përfituar nga globalizimi.

Karakteri transnacional i krimit të organizuar e përcakton atë pa dyshim si një fenomen ndërkombëtar, që mund të trajtohet vetëm në mënyrën e duhur – në mënyrë globale dhe përmes përpjekjeve ndërkombëtare. Një nga pyetjet vendimtare është nëse komuniteti ndërkombëtar është i gatshëm të pranojë përgjegjësinë për të reaguar. Nevojitet të promovohen forma të reja të të menduarit mbi sigurinë. Aspekti social duhet të integrohet në politikat e sigurisë, kur kërkohen qasje të reja për të adresuar ndikimin e krimit të organizuar mbi qeverisjen demokratike.

Përpjekjet tona për të promovuar demokracinë nuk kanë vlerë për aq kohë sa nuk gjenden zgjidhje për proceset e përshkruara. Prandaj është e rëndësishme të ndërtohet një vizion i përbashkët mes aktorëve dhe të projektohen instrumente që mund të përballojnë në mënyrë efektive ndikimin negativ të krimit të organizuar mbi qeverisjen demokratike.

Prandaj, e vlerësoj shumë faktin që kemi mundësinë të kontribuojmë në procesin e forcimit të dialogut mbi sigurinë dhe politikat progresive përmes këtij edicioni të Barometrit Shqiptar të Sigurisë.

Katharina Hofmann

Përfaqësuese Rezidente

Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra Tiranë

HYRJE

Që nga krijimi i tij në vitin 2019, Barometri i Sigurisë është kthyer në një gur themeli për të kuptuar perceptimet e qytetarëve shqiptarë mbi sigurinë. I zhvilluar çdo vit nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG), ai mbetet i vetmi sondazh kombëtar që mat në mënyrë sistematike qëndrimet, opinionet dhe përvojat e qytetarëve lidhur me sigurinë. Duke ndjekur këto perceptime me kalimin e kohës, Barometri i Sigurisë jo vetëm që identifikon rreziqet që po shfaqen, por gjithashtu ofron një bazë të besueshme provash për reagimet politike dhe institucionale.

Baza analitike e Barometrit është qasja e Reformës në Sektorin e Sigurisë – një proces politik dhe teknik që synon përmirësimin e sigurisë shtetërore dhe njerëzore, duke integruar parimet e qeverisjes së mirë në sektorin e sigurisë. Kjo nënkupton jo vetëm vlerësimin e kapacitetit të institucioneve për të ofruar siguri, por edhe të llogaridhënies, transparencës dhe respektimit të të drejtave të njeriut nën mbikëqyrjen civile demokratike.

Edicioni 2025 publikohet në një periudhë të shënuar nga paqëndrueshmëri e vazhdueshme dhe kërcënime në zhvillim. Pasojat e pandemisë COVID-19, lufta e Rusisë në Ukrainë, tensionet e rinovuara në Lindjen e Mesme, konkurrenca gjithnjë në rritje mes modeleve demokratike dhe autoritare, rreziqet e shkaktuara nga klima dhe cenueshmëritë kibernetike e kanë vendosur sigurinë fuqishëm në qendër të ndërgjegjes publike. Për Shqipërinë, këto sfida globale ndërthuren me mosmarrëveshjet e pazgjidhura rajonale, imperativat e integritit në BE dhe sfidat e qëndrueshme të qeverisjes, duke formësuar si natyrën e kërcënimeve ashtu edhe pritshmëritë publike për performancën institucionale.

Ndërkohë që edicioni 2024 përdori një qasje më të gjerë të sigurisë njerëzore, sondazhi i këtij viti përqendrohet në katër fusha të ndërlidhura që dominojnë shqetësimet e qytetarëve për sigurinë dhe formësojnë debatet politike kombëtare:

Kërcënimet e sigurisë: eksploron se si shqiptarët perceptojnë kërcënimet më serioze dhe dytësore ndaj sigurisë kombëtare. Përmes analizës së këtyre perceptimeve në grupe demografike dhe gjeografike, Barometri ofron një pamje të detajuar mbi shpërndarjen e ndërgjegjësimit për rrezikun dhe zhvillimin e tij krahasuar me vitet e mëparshme.

Gjeopolitika dhe marrëdhëniet me vendet e tjera: shqyrton opinionin publik mbi orientimin e politikës së jashtme të Shqipërisë, si tregues kyç i identitetit strategjik të vendit. Kjo tematikë përfshin qëndrimet ndaj fuqive të mëdha globale – SHBA, BE, Rusia dhe Kina – si edhe ndaj shteteve fqinje ballkanike, duke matur perceptimet mbi ndikimin e tyre, rolin në çështjet globale, partnerët strategjikë të preferuar dhe balancën mes bashkëpunimit transatlantik dhe atij rajonal.

Krimi i organizuar: Krimi i organizuar, i cili mbetet një nga kërcënimet më komplekse dhe më të rrënjosura për sigurinë dhe qeverisjen në Shqipëri. Ky edicion i Barometrit pasqyron perceptimet mbi përhapjen e tij në nivel lokal dhe kombëtar, identifikon aktivitetet e krimit të organizuar që konsiderohen më të

dëmshme dhe shqyrton mendimet e publikut mbi shkaqet kryesore të tij. Gjithashtu, mat besimin e qytetarëve tek reagimi institucional, përfshirë organet e rendit, gjyqësorin dhe strukturat e posaçme kundër korrupsionit, duke ofruar njohuri mbi zonat ku besimi po ndërtohet dhe ku po gërryhet.

Kriminaliteti dhe raportimi i tij: përvojat e drejtpërdrejta ose të tërthorta të qytetarëve me krimin dhe gatishmëria e tyre për ta raportuar atë janë tregues kritikë të sigurisë publike dhe të besueshmërisë institucionale. Kjo tematikë analizon llojet e krimeve të hasura, sjelljen në raportim, pengesat për të raportuar (si frika nga hakmarrja ose mungesa e besimit tek autoritetet) dhe perceptimet mbi krimet që mbeten më shpesh të pareportuara.

Duke e ngushtuar fokusin tek këto katër fusha, Barometri i Sigurisë 2025 ofron një portret të përqendruar, por gjithëpërfshirës të mjedisit të sigurisë në Shqipëri, ashtu siç perceptohet nga qytetarët. Ky fokus pasqyron ndërthurjen e qeverisjes, gjeopolitikës, krimit dhe sigurisë komunitare si elementë përcaktues të peizazhit aktual të sigurisë.

Dizajni i anketës – që kombinon kampionimin përfaqësues me module tematike të detajuara – siguron që gjetjet e saj të jenë si përfaqësuese në nivel kombëtar, ashtu edhe me rëndësi për politikën. Ato nxjerrin në pah se ku publiku sheh përparim, ku dobësitë mbeten akute dhe ku legjitimiteti institucional është më shumë në rrezik.

Qëllimi përfundimtar i Barometrit të Sigurisë mbetet i pandryshuar: të informojë politikëbërjen e bazuar në evidenca dhe të nxisë një diskurs mbi sigurinë të mbështetur në llogaridhënie demokratike, të drejtat e njeriut dhe besimin publik. Për institucionet shtetërore, Barometri është një instrument diagnostikues; për shoqërinë civile, ai është një platformë advokimi; dhe për partnerët ndërkombëtarë, ai përfaqëson një dritare drejt dinamikave shoqërore që qëndrojnë në themel të politikave dhe zgjedhjeve strategjike të Shqipërisë.

Në një epokë kur kufijtë midis sigurisë së brendshme dhe asaj ndërkombëtare po bëhen gjithnjë e më të paqartë, Barometri i Sigurisë 2025 shërben si pasqyrë e opinionit publik dhe si busull për drejtimin e politikave – duke kapur zërin e qytetarëve në një kohë kur siguria nuk ka qenë kurrë më e kontestuar, më komplekse dhe më vendimtare.

METODOLOGJIA

Pyetësi

Anketa është hartuar me kujdes për të paqyruar në mënyrë gjithëpërfshirëse pikëpamjet e qytetarëve shqiptarë mbi sigurinë kombëtare, marrëdhëniet rajonale, integrimin evropian dhe krimin e organizuar. Përfshirja e pyetjeve demografike mundëson analizë të shtresëzuar, duke siguruar që njohuritë të mund të analizohen sipas grupeve të ndryshme të popullsisë. Një temë qendrore është perceptimi i kërcënimeve ndaj sigurisë, si të brendshme (korrupsioni, krimi i organizuar, terrorizmi, krimi kibernetik) ashtu edhe të jashtme (tensionet rajonale), të cilat pasqyrojnë sfidat e vazhdueshme të Shqipërisë për të ruajtur stabilitetin dhe sovranitetin. Seksioni i gjerë mbi krimin e organizuar shqyrton shtrirjen e tij, shkaqet dhe ndikimin mbi politikën, ekonominë dhe besimin tek institucionet, duke theksuar një çështje kritike të qeverisjes me pasoja të drejtpërdrejta për anëtarësimin në BE. Pyetjet mbi viktimizimin dhe raportimin hedhin dritë mbi besimin e qytetarëve tek institucionet e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë, një element kyç për ndërtimin e qëndrueshmërisë demokratike.

Përtej sigurisë së brendshme, sondazhi eksploron bashkëpunimin rajonal dhe pajtimin në Ballkan, duke njohur rolin e Shqipërisë në një fqinjësi komplekse ku mosmarrëveshjet historike vazhdojnë të formësojnë perceptimet publike. Në të njëjtën kohë, pyetjet mbi ndikimin e aktorëve globalë (SHBA, BE, Rusia, Kina) dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare (NATO, OSBE, OKB) ofrojnë njohuri mbi mënyrën se si shqiptarët e vendosin vendin e tyre brenda dinamikave më të gjera gjeopolitike. Më në fund, seksioni mbi anëtarësimin në BE eksploron si përfitimet e perceptuara ashtu edhe pritshmëritë rreth afatit të pranimit, duke pasqyruar përparësinë strategjike të Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Evropian.

Kampionimi

Kampioni i anketës u stratifikua me kujdes për të pasqyruar popullsinë e rritur të Shqipërisë, duke zbatuar kuota strikte për të garantuar përfaqësueshmërinë. Për këtë anketë u zgjodh një kampion i rastësishëm shumëstresor prej 1,111 të rriturish. Në fazën e parë, pyetësorët u shpërndanë në mënyrë proporcionale në 61 bashkitë e Shqipërisë sipas numrit të popullsisë së tyre të rritur. Në fazën e dytë, të anketuarit u përzgjedhën në mënyrë proporcionale nga zonat urbane dhe rurale brenda secilës bashki, duke përdorur metodën e rrjetit qelizor (cell-web) në rajonet NUTS-3.

Për të garantuar ekuilibrin demografik, u aplikuan kuota gjinore (50%-50%) dhe kuota për grupmoshat (25%-25%-25%-25%) brenda secilës nënshtrëse. Përfaqësimi gjeografik u siguroi më tej përmes pikave të gjeolokacionit të zgjedhura rastësisht në të gjithë Shqipërinë, duke ndjekur modelin e kampionimit (shih Shtojcën 1).

Intervistat mbuluan të gjitha prefekturat kryesore, Tirana përfaqësonte 30% të kampionit, e ndjekur nga Fieri (11.7%), Durrësi (9.7%) dhe Elbasani (9.2%), duke reflektuar peshën demografike të këtyre rajoneve. Në nivel bashkie, Tirana (22.6%), Durrësi (6.6%) dhe Elbasani (4.8%) dolën si kontribues kryesorë, duke siguruar si mbulim kombëtar dhe granularitet në nivel lokal.

Kjo strategji shumëstresore e kampionit u hartua për të siguruar përfaqësim të saktë gjeografik dhe demografik të popullsisë së rritur të Shqipërisë, duke e mbajtur gabimin e kampionimit nën $\pm 2.9\%$ për të gjithë kampionin. Duke garantuar që çdo individ të kishte të njëjtin probabilitet për t'u përzgjedhur, kjo qasje minimizon paragjykimin dhe garanton që gjetjet pasqyrojnë në mënyrë të besueshme qëndrimet dhe perceptimet e popullsisë së rritur të Shqipërisë.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

Ky anketë u krye nëpërmjet intervistave ballë për ballë, sipas planit të mësipërm të kampionimit. Për të siguruar cilësinë e të dhënave, 28 intervistuesit u nënshtruan një trajnimit të plotë nga ekipi i menaxhimit të projektit përpara se të fillonin punën në terren. Mbledhja e të dhënave përfshiu periudhën 19-27 maj 2025. Intervistuesit futën përgjigjet direkt në një aplikacion për smartphone, i cili i transmetoi të dhënat menjëherë në një server qendror nëpërmjet një programi të krijuar posaçërisht. Koha dhe vendndodhja e secilës intervistë u regjistruan automatikisht, duke i mundur drejtorit të statistikave të kryente monitorim të përditshëm dhe të siguronte respektimin e planit të paracaktuar të marrjes së mostrave dhe udhëzimeve metodologjike.

Në përfundim të punës në terren, u krye një kontroll gjithëpërfshirës i cilësisë së të dhënave të mbledhura të intervistës. Përpara analizës së të dhënave, kampioni u ripeshua për të pasqyruar shpërndarjen proporcionale të moshës në Shqipëri, siç raportohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT), duke rritur më tej përfaqësimin e të dhënave. Të dhënat e ripeshuara u përpunuan dhe u analizuan më pas duke përdorur programin statistikor STATA 13.

Analizimi i të dhënave

Të dhënat e mbledhura u grupuan dhe u analizuan sipas temave kryesore të zgjedhura:

1. Informacion demografik
2. Kërcënime ndaj sigurisë
3. Gjeopolitika dhe marrëdhëniet me vendet e tjera
4. Krimi i organizuar
5. Viktimizimi dhe raportimi i krimit

Të dhënat paraqiten grafikisht dhe në tabela për të përmirësuar kuptueshmërinë dhe lexueshmërinë. Interpretimi i të dhënave pasqyron kuptimin e autorit, por rezultatet e plota të anketës ofrohen për t'u lejuar lexuesve të kryejnë analizat e tyre dhe të nxjerrin përfundime të pavarura.

Sfidat

Është e rëndësishme të njihen disa kufizime në të dhënat dhe analizën e paraqitur në këtë raport. Së pari, anketat e opinionit publik janë në vetvete të ndjeshme ndaj paragjytimeve dhe pasaktësive. Të anketuarit mund të hezitojnë të japin përgjigje të sinqerta për pyetje të ndjeshme, veçanërisht ato që lidhen me aktivitetin kriminal. Së dyti, të dhënat e anketës ofrojnë një pamje të perceptimeve publike në një moment të caktuar kohor dhe mund të mos pasqyrojnë plotësisht kompleksitetin dhe dinamizmin e krimit të organizuar. Së treti, mbështetja tek burimet dytësore mund të sjellë paragjytime ose pasaktësi shtesë në analizë. Megjithë këto kufizime, ky raport përfaqëson një kontribut të vlefshëm në lidhje me krimin e organizuar në Shqipëri. Duke ofruar një vlerësim të bazuar në evidenca mbi këtë tematikë, raporti synon të informojë debatet mbi politikat, të nxisë ndërgjegjësimin publik dhe të mbështesë përpjekjet për të luftuar krimin e organizuar dhe për të promovuar sundimin e ligjit.

GJETJE KRYESORE

KËRCËNIMET NDAJ SIGURISË KOMBËTARE



Shqetësimet e qytetarëve shqiptarë për sigurinë dominohen nga rreziqet e brendshme që lidhen me qeverisjen, më shumë sesa nga kërcënimet tradicionale ushtarake apo ato natyrore. **Korrupsioni del si kërcënimi kryesor për sigurinë kombëtare**, i përmendur shumë më shpesh se të tjerët, duke reflektuar shqetësimin e publikut mbi dobësinë institucionale dhe dobësimin e shtetit të së drejtës. **Krimi i organizuar renditet menjëherë pas tij**, duke përforcuar perceptimin për ndërthurjen e ngushtë mes rrjeteve kriminale dhe strukturave të korruptuara të qeverisjes.

Kur kërcënimet parësore dhe dytësore merren së bashku, korrupsioni dhe krimi i organizuar renditen dukshëm mbi të tjerat, ndërkohë që konflikti ushtarak i jashtëm, krimi kibernetik, pandemitë dhe presionet migratore shihen si të rëndësishme, por më pak urgjente. Kjo hierarki nxjerr në pah një **paradigmë sigurie ku rreziqet më të mëdha perceptohen si të brendshme**, të rrënjosura në dobësitë sistemike dhe jo në agresionin e jashtëm.

Pesha që qytetarët i japin këtyre kërcënimeve të brendshme pasqyron njëkohësisht shqetësim diagnostik dhe normativ: **stabiliteti dhe qëndrueshmëria e Shqipërisë varen më pak nga kapaciteti ushtarak dhe më shumë nga integriteti, transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve.**

Marrëdhëniet Rajonale



Të dhënat tregojnë se ekziston një mbështetje e fortë për bashkëpunim më të ngushtë mes shteteve të Ballkanit për t'u përballur me sfidat e përbashkëta të sigurisë. Shumica dërrmuese e qytetarëve shprehen se mungesa e bashkëpunimit minon stabilitetin rajonal.

Qytetarët janë të vetëdijshëm se kërcënimet ndërkufitare si krimi i organizuar, trafikimi apo migracioni i parregullt nuk mund të kontrollohen në mënyrë të njëanshme dhe kërkojnë veprim të koordinuar.

Megjithëse prirja për bashkëpunim është e qartë, **optimizmi për sigurinë në Ballkan në të ardhmen e afërt mbetet i rezervuar**. Ndërsa shumica parashikojnë përmirësim, një pjesë e konsiderueshme mbetet skeptike, duke pasqyruar ndërgjegjësimin për mosmarrëveshjet e rrënjosura dhe besimin e brishtë midis shteteve.

Pengesa më e rëndësishme sipas perceptimit publik për pajtimin është roli i politikanëve, të cilët shihen si të vetëm për përfitim vetjak dhe si nxitës të ndarjeve për përfitime politike. Ky cinizëm tregon kërkesën për modele të reja lidhshpimi politik dhe për forcimin e mbikëqyrjes qytetare. Serbia identifikohet në mënyrë dërmuese si kërcënim kryesor për sigurinë e Shqipërisë, ndërsa fqinjët e tjerë shihen kryesisht në mënyrë neutrale, duke treguar se perceptimet mbi kërcënimet formësohen ende më shumë nga konfliktet historike dhe mosmarrëveshjet e pazgjidhura politike, sesa nga konkurrenca ekonomike apo kulturore.

GJEOPOLITIKA DHE ÇËSHTJET GLOBALE



Ndikimi gjeopolitik



Opinion i publik në Shqipëri **mbështet qartë orientimin përëndimor të vendit. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian** gëzojnë vlerësime shumë pozitive për ndikimin e tyre, ndërsa **Rusia** shihet kryesisht si kërcënim. **Kina perceptohet më në mënyrë më neutrale**, me ndikim të përzier – as partner i besueshëm, por as kërcënim i drejtpërdrejtë.

BE perceptohet nga shumica e qytetarëve si një aktor që vepron për të mirën globale; SHBA gëzon miratim të ngjashëm, ndonëse një pjesë disi më e madhe e qytetarëve pranojnë një kombinim të veprimeve pozitive dhe negative. Veprimet e Rusisë perceptohen pothuajse unanimisht si dashakeqe, ndërsa **roli i Kinës shihet në mënyrë më të dyzuar**.

Çështjet globale dhe prioritetet e politikës së jashtme



Qytetarët presin që **SHBA të mbetet aktori global më me ndikim**, e ndjekur në distancë nga BE, Kina dhe Rusia. **Sa u përket prioritetëve dypalëshe, Italia renditet e para, e ndjekur ngushtë nga SHBA** çka pasqyron lidhjet historike-kulturore dhe interesat strategjike të sigurisë. Publiku bën dallim midis “marrëdhënieve më të mira aktuale” (ku kryeson Italia) dhe “marrëdhënieve që duhet të prioritizohen” (ku kryeson SHBA), duke treguar dëshirën për t’i thelluar më tej këto marrëdhënie strategjike duke i parë si themel të partneritetit afatgjatë dhe të besueshëm.

Marrëdhëniet transatlantike dhe organizatat ndërkombëtare



NATO dhe BE konsiderohen thelbësore për sigurinë kombëtare të Shqipërisë, me mbështetje pothuajse unanime për rëndësinë e tyre. **OSBE dhe OKB shihen si të rëndësishme, por më pak qendrore**. Shumica presin **afrimin e mëtejshëm të marrëdhënieve SHBA–BE**, duke reflektuar një vizion optimist mbi vazhdimësinë e kohezionit transatlantik.


ANËTARËSIMI NË BE



Mbështetja për anëtarësimin në BE është pothuajse e përgjithshme dhe bazohet në përfitime pragmatike – mundësi ekonomike, liri lëvizjeje dhe cilësi jete më të mirë, krahas vlerave si demokracia dhe paqja. **Mirëqenia ekonomike dhe mundësia për të jetuar, punuar e studiuar kudo në BE** përmenden më shpesh, si përfitimet personale kryesore, veçanërisht nga të rinjtë.

Megjithëse **optimizmi për anëtarësim deri në vitin 2030 është i përhapur, ai shoqërohet me skepticizëm**: një pakicë e konsiderueshme dyshon se Shqipëria do të mund të përmbushë kriteret apo të kapërcejë pengesat politike dhe burokratike në kohë. **Edhe midis skeptikëve, pak janë ata që e refuzojnë anëtarësimin në mënyrë kategorike**; shumica e shohin thjesht si një objektiv afatgjatë. Kështu, integrimi në BE shihet jo vetëm si zgjedhje e politikës së jashtme, por si një shtyllë e vizionit të zhvillimit kombëtar.

KRIMI I ORGANIZUAR: PERCEPTIME DHE QËNDRIME



Shkalla e Problemit dhe Aktivitetet



Krimi i organizuar shihet nga shumica e qytetarëve si një **problem shumë serioz në nivel kombëtar**, edhe pse më pak i dukshëm në mjediset lokale – duke sugjeruar një **hendek perceptimi midis narrativës kombëtare dhe dukshmërisë lokale**. Rajonet veriore dhe qendrore (Shkodër, Elbasan, Lezhë) perceptohen si zona të nxehta të aktivitetit kriminal.

Trafikimi i drogës del si aktiviteti kryesor, i ndjekur nga pastrimi i parave dhe krimi i dhunshëm. Kultivimi dhe trafikimi i kanabisit shihet si **faktor kyç që ushqen** krimin e organizuar, megjithëse publiku mbetet i ndarë mbi idenë se **legalizimi do ta zvogëlonte përfshirjen kriminale**.

Faktorët dhe Shkaqet Kryesore



Varfëria, papunësia dhe problemet familjare konsiderohen si **shtysat kryesore socio-ekonomike** për rekrutimin në krim, veçanërisht tek të rinjtë. Nga ana institucionale, **dënimet e buta, korrupsioni dhe lidhjet politikë–krim shihen si lehtësues kryesorë**, duke krijuar një mjedis ku rrjetet kriminale veprojnë pa ndëshkim.

Faktorët Institucionalë



Dënimet e buta, korrupsioni dhe lidhjet politikë-krim perceptohen si **nxitësit kryesorë institucionalë**, të cilët krijojnë kushte që u japin hapësirë grupeve kriminale të veprojnë me imunitet. Dëmet e identifikuar shkojnë përtej aspektit ekonomik, duke përfshirë, cenimin e sistemit të drejtësisë, dobësimin e demokracisë, dhe frikësimin e publikut.

Ndikimi



Krimi i organizuar perceptohet gjerësisht si faktor që **shtrembëron konkurrencën e tregut**, kryesisht përmes evazionit fiskal, zhvatjes dhe frikësimit, duke ndikuar kryesisht tek bizneset e mëdha. Ndikimi i tij shihet si i përhapur **në politikë, qeverisje, gjyqësor dhe media**. SPAK dhe

Gjykatat e Posaçme shihen si më të mbrojtura nga ky ndikim, në krahasim me gjykatat e zakonshme ose prokuroritë e rretheve, të cilat konsiderohen si më të ekspozuara.

Zgjedhjet e 11 majit 2025



Shumica e qytetarëve besojnë se krimi i organizuar ka ndikuar si tek **partitë politike, ashtu edhe në rezultatin e zgjedhjeve**, kryesisht përmes blerjes së votës, financimeve të paligjshme dhe deri diku frikësimit. Këto perceptime nuk janë thjesht abstrakte apo të ndërtuara mbi narrativat mediatike: shumë qytetarë besojnë se qarqet e tyre janë prekur drejtpërdrejt, veçanërisht Elbasani, Tirana, Fieri dhe Shkodra.

Media tradicionale mbetet burimi kryesor i informacionit mbi këtë ndikim, por edhe përvojat personale janë domethënëse: një në pesë qytetarë thotë se një dikë që është kontaktuar për të ndikuar mbi votën e tij, ndërsa një në katër një dikë që ka shkëmbyer votën për para ose favore.

Efektiviteti i performancës institucionale në parandalim



SPAK perceptohet si institucioni **më i besueshëm** për parandalimin e ndërhyrjes kriminale në zgjedhje, ndryshe nga partitë politike, të cilat shihen si krejtësisht të dështuara në këtë drejtim. Pas tij, perceptimet janë më të ndara për Policinë e Shtetit dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të cilët marrin vlerësime të përziera nga publiku. Partitë politike perceptohen në mënyrë dërrmuese si të **dështuara në këtë përgjegjësi**, duke u parë si të kompromentuara ose të paafta për të frenuar ndikimin kriminal. SPAK shihet si shtylla kryesore e integritetit elektoral, në kontrast të fortë me perceptimin për institucionet e tjera të cilat shihen si të kompromentuara ose joefektive.

Tendencat, pritshmëritë dhe reformat




Gjatë tre viteve të fundit, shumë qytetarë ndiejnë se prania e **krimin të organizuar është rritur ose ka mbetur e pandryshuar**, ndërsa një numër më i vogël e percepton një përmirësim. Ligji për Dekriminalizimin i vitit 2015 shihet si pjesërisht efektiv, por dyshimet mbi shtrirjen e tij mbeten të forta, veçanërisht në nivelin e qeverisjes vendore dhe qendrore.

Pritshmëritë për reduktimin e **ndikimit të krimin të organizuar mbi politikën dhe ekonominë** janë pothuajse të ndara në mënyrë të barabartë mes optimizmit dhe skepticizmit. Në këtë panoramë, **SPAK del sërish si aktori institucional më i besuar**, krahas partnerëve ndërkombëtarë, BE-së dhe SHBA-së, roli i të cilëve perceptohet si shumë i rëndësishëm në mbështetjen e kapaciteteve të Shqipërisë për të luftuar krimin e organizuar.

Megjithatë, shqetësimet për **politizimin e sistemit të drejtësisë** vazhdojnë të jenë të pranishme, edhe pse pjesërisht zbuten nga një nivel i caktuar besimi tek procesi i vetingut. Në të njëjtën kohë, **dënimet ndaj të përfshirëve në krimin e organizuar** perceptohen në mënyrë dërmuese si tepër të buta, duke kontribuar në ndjenjën e mosndëshkueshmërisë.

VIKTIMIZIMI DHE RAPORTIMI I KRIMIT



Shkalla e viktimizimit të drejtpërdrejtë është e ulët, por **ekspozimi indirekt** përmes miqve dhe familjes është i përhapur. Nivelet e raportimit janë shumë të ulëta, të ndikuara nga **frika e hakmarrjes, mungesa e besimit** tek autoritetet dhe mungesa e njohurive ligjore.


Krimet e kryera nga aktorë të fuqishëm, zyrtarë qeveritarë dhe dhuna në familje **perceptohen si më të prirura për të mbetur të paraportuara**. Qytetarët e shohin **sistemin e drejtësisë si selektiv në mbrojtje dhe të pabarabartë në zbatim**, duke krijuar një kulturë të distancimit nga institucionet formale.

Në përmbledhje, Barometri i Sigurisë 2025 nxjerr në pah një panoramë sigurie ku **kërcënimet kryesore të perceptuara nga publiku për Shqipërinë janë të brendshme**, të rrënjosura në dobësitë e qeverisjes dhe në përhapjen e thellë sistemike të krimit të organizuar. **Besimi publik është shumë i diferencuar**: SPAK dhe partnerët ndërkombëtarë gëzojnë legjitimitet të fortë, ndërsa partitë politike, gjykatat e zakonshme dhe Policia e Shtetit përballen me skepticizëm të thellë. Qytetarët mbështesin **bashkëpunim më të ngushtë rajonal, orientim të qëndrueshëm perëndimor dhe integrimin në BE**, por mbeten të vetëdijshëm për **brishtësinë e reformave** dhe asimetritë e pushtetit që rrezikojnë të minojnë konsolidimin demokratik.

ANALIZË E DETAJUAR E REZULTATEVE TË ANKETËS


INFORMACION DEMOGRAFIK

Kampioni i anketës tregon një barazi pothuajse të plotë gjinore, me një ndarje praktikisht të barabartë mes meshkujve (50.1%) dhe femrave (49.9%), duke siguruar një përfaqësim të ekuilibruar. Struktura demografike sipas moshës pasqyron një shpërndarje relativisht të balancuar ndërmjet grupmoshave, duke filluar nga të rinjtë (18–34 vjeç me 25.9%) deri tek të moshuarit mbi 65 vjeç (24.5%).




Grafik 1 dhe 2. Mosha dhe gjinia e të pyeturve

Të dhënat e anketës pasqyrojnë përbërjen etnike të Shqipërisë, me një shumicë dërrmuese që identifikohen si shqiptarë (96.8%), ndërkohë që përfshihen edhe përgjigje nga grupe më të vogla minoritare. Mes të punësuarve, anketa tregon një ndarje pothuajse të barabartë midis atyre që jetojnë në zona urbane (41.3%) dhe atyre që nuk punojnë (41.1%).




Grafik 3 and 4. Etnia dhe zona e intervistimit të të anketuarve

Profili arsimor i të anketuarve tregon se më shumë se gjysma e tyre kanë përfunduar shkollën e mesme (53.0%), ndërsa një pjesë e konsiderueshme zotëron diplomë universitare (26.1%) ose pasuniversitare (4.4%), çka tregon se popullsia ka një nivel arsimimi relativisht të lartë.



Grafik 5. Niveli i arsimit të të anketuarve

Të dhënat mbi punësimin pasqyrojnë një treg pune të shumëllojshëm, me përfaqësim të konsiderueshëm të pensionistëve (27.2%) dhe të vetëpunësuarve (20.8%), si edhe të punonjësve në sektorë të ndryshëm, duke ofruar një panoramë të detajuar të tregut të punës në Shqipëri.



Grafik 6. Punësimi i të anketuarve



**KËRCËNIMET NDAJ
SIGURISË KOMBËTARE**

KËRCËNIMET NDAJ SIGURISË KOMBËTARE


Ky kapitull analizon perceptimet publike mbi kërcënimet më serioze të sigurisë me të cilat përballet aktualisht Shqipëria. Vlerësimi i perceptimeve të qytetarëve për kërcënimet e sigurisë është thelbësor për një qeverisje efektive. Të anketuarit u pyetën të renditnin kërcënimet sipas rëndësisë, duke hedhur dritë mbi ato që perceptohen si më të rëndësishmet për vetëdijen kombëtare. Për këtë qëllim, u shtruan pyetjet:

- Cili mendoni se është kërcënimi më serioz i sigurisë për Shqipërinë?
- Cili mendoni se është kërcënimi i dytë më serioz i sigurisë për Shqipërinë?

Rezultatet tregojnë se korrupsioni shihet si kërcënimi kryesor, i identifikuar nga **47.3% e të anketuarve**. Megjithatë korrupsioni mbizotëron, krimi i organizuar paraqitet si shqetësim i rëndësishëm, me **19.1%** të qytetarëve të anketuar që e rendisin si kërcënimin kryesor. Interesant është fakti se, kur bëhet fjalë për kërcënimin e dytë më serioz, krimi i organizuar shënon një rritje në **26.8%** të të anketuarve që e rendisin si kërcënimin e dytë më serioz.

Këto shqetësime zënë vendin kryesor ndaj ndaj kërcënimeve tradicionale ushtarake dhe rreziqeve të reja kibernetike, duke nxjerrë në pah perceptimin për cenueshmërinë e institucioneve dhe strukturave të qeverisjes. Terrorizmi, migrantët e huaj, ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë natyrore shihen si shqetësime më pak urgjente krahasuar me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Cili mendoni se është aktualisht kërcënimi më serioz dhe kërcënimi i dytë më serioz për sigurinë e Shqipërisë?



Grafik 7. Opinioni mbi kërcënimet më serioze për sigurinë kombëtare të Shqipërisë

Tabela më poshtë paraqet një renditje të përgjigjeve të kombinuara të "kërcënimit kryesor të sigurisë" dhe "kërcënimit të dytë më serioz të sigurisë" me të cilin përballet Shqipëria.

Kërcënimi	Kërcënimi kryesor (%)	Kërcënimi i dytë kryesor (%)	Renditja e kombinuar
Korrupsion	47.3	20.9	1
Krimi i organizuar	19.1	26.8	2
Lufta me vendet e tjera	12.5	11.5	3
Krimi kibernetik	6.2	13.7	4
Pandemitë	5.5	8.5	5
Migrantët e huaj	1.9	5.6	6
Ndryshimet klimatike	2.7	4.3	7
Fatkeqësi natyrore	2.1	4.0	8
Terrorizmi	2.7	4.6	9

Table 1. Renditja e kombinuar e kërcënimit të parë dhe të dytë



MARRËDHËNIET RAJONALE

MARRËDHËNIET RAJONALE


Ky kapitull i anketës ofron një pasqyrë mbi mënyrën se si shqiptarët e perceptojnë rolin e vendit të tyre në sigurinë rajonale dhe marrëdhëniet me shtetet fqinje të Ballkanit. Këto të dhëna janë thelbësore për të kuptuar kuadrin më të gjerë të sigurisë dhe përpjekjet për bashkëpunim. Për këtë qëllim, u parashtruan pyetjet:

- *Mendoni se mungesa e bashkëpunimit ndërmjet shteteve të Ballkanit ndikon negativisht në marrëdhëniet mes tyre?*
- *Për t'u përballur me kërcënimet dhe sfidat e sigurisë, a jeni dakord që Shqipëria duhet të zhvillojë bashkëpunim më të ngushtë me të gjitha vendet e rajonit?*
- *Mendoni se siguria në Ballkan do të përmirësohet gjatë katër viteve të ardhshme?*
- *Çfarë mendoni se pengon pajtimin dhe ndërtimin e paqes në Ballkan?*
- *Cilat vende të Ballkanit i perceptoni si kërcënim për sigurinë e Shqipërisë?*

Mungesa e bashkëpunimit mes shteteve ballkanike perceptohet gjerësisht si një pengesë serioze për marrëdhëniet rajonale. Pothuajse nëntë nga dhjetë të anketuar—duke kombinuar ata që janë përgjigjur **“Po” (47.0%) dhe “Anoj nga Po” (41.8%)** besojnë se bashkëpunimi i pamjaftueshëm mes vendeve fqinje ndikon negativisht në dinamikën ndër-shtetërore. Vetëm një pakicë e vogël, **6.7%** me tendencë për të mos u dakordësuar dhe 3.4% që e kundërshtojnë plotësisht këtë nocion, shprehin skepticizëm mbi ndikimin e bashkëpunimit të dobët. Fakti që vetëm **1.0%** nuk janë të sigurt tregon se kjo çështje është e kuptuar qartë dhe e diskutuar gjerësisht nga qytetarët.

Ky konsensus i gjerë tregon se publiku shqiptar është i vetëdijshëm për tensionet rajonale, por njëkohësisht beson fuqimisht se besimi, dialogu dhe veprimi i përbashkët janë elementë thelbësorë për stabilitetin në Ballkan.


A mendoni se mungesa e bashkëpunimit ndërmjet shteteve të Ballkanit ndikon negativisht në marrëdhëniet mes tyre?



Grafik 8. Opinioni mbi ndikimin e mungesës së bashkëpunimit ndërmjet shteteve të Ballkanit në marrëdhëniet mes tyre

Megjithëse niveli i plotë i besimit mbetet i ulët, një total prej **64.5% të të anketuarve** shprehin një nivel optimizmi lidhur me përmirësimin e sigurisë në Ballkan gjatë katër viteve të ardhshme (**19.3% janë përgjigjur “Po” dhe 45.2% “Anoj nga Po”**). Ky optimizëm i matur tregon se, ndonëse qytetarët shpresojnë për përmirësim, ata mbeten realistë për sfidat ekzistuese.

A mendoni se siguria në Ballkan do të përmirësohet gjatë 4 viteve të ardhshme?



Grafik 9. Opinioni mbi përmirësimin e sigurisë në Ballkan gjatë 4 viteve të ardhshme


Pengesa për pajtimin

Të dhënat ofrojnë një pasqyrë të kthjellët mbi pengesat që hasen në procesin e pajtimit dhe ndërtimit të paqes në Ballkan, duke zbuluar një publik që është njëkohësisht politikisht i mprehtë dhe i vetëdijshëm historikisht. Perceptimi dominues—i mbajtur nga **40.1%** e të anketuarve—është se **aktorët politikë që**

përfitojnë nga ndarjet e vazhdueshme përbëjnë pengesën kryesore për paqen. Kjo tregon skepticizëm të gjerë ndaj udhëheqjes vendase dhe një bindje se konflikti, të paktën pjesërisht, mbahet qëllimisht për përfitime politike.

Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë (**29.5%**) ia atribuon mungesën e progresit **ndërhyrjes të fuqive globale**. Kjo pasqyron një vetëdije rajonale të formësuar nga dekada manovrash gjeopolitike, ku ndikimi i jashtëm shihet jo si ndërmjetësim neutral, por si një forcë komplikimi që shpesh përkeqëson tensionet lokale.

Interesant është fakti se mosbesimi ndërpersonal mes popujve të Ballkanit përbën 16.0% të përgjigjeve, duke treguar se, ndonëse ekzistojnë pasiguri shoqërore, ato nuk shihen si shkak themelor. Diferencat etnike (9.3%) dhe ndarjet fetare (3.9%) përmenden shumë më rrallë, duke sugjeruar se faktorët e bazuar në identitet — të cilët shpesh theksohen në narrativat historike — tani perceptohen si dytësorë ndaj dinamikave politike dhe strategjike.



Grafik 10. Opinioni mbi pengesat për pajtimin dhe ndërtimin e paqes në Ballkan

Kërcënimet e perceptuara sipas vendeve


Shqiptarët e perceptojnë Serbinë si kërcënimin më të madh të sigurisë në Ballkan, me **61.7%** të të anketuarve që e identifikojnë si të tillë. Këto qëndrime pasqyrojnë tensionet e hershme historike, veçanërisht mbi Kosovën, si dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme politike, të cilat formësojnë perceptimin publik mbi stabilitetin rajonal.

Një përqindje më e vogël, por gjithsesi domethënëse **25.3%**, e konsideron Bosnjë dhe Hercegovinën si një kërcënim të mundshëm —një perceptim që lidhet kryesisht me shqetësimet mbi paqëndrueshmërinë e brendshme të këtij vendi,

tensionet etnike dhe ndikimin më të gjerë të brishtësisë rajonale në mjedisin e sigurisë së Shqipërisë.

Ndërkohë, fqinjët e tjerë perceptohen shumë më pak si kërcënime: Greqia përmendet nga **8.3%** e të anketuarve, ndoshta e lidhur me mosmarrëveshje e herëpashershme mbi të drejtat e minoriteteve, kufijtë detarë ose çështje historike. Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia dhe Maqedonia e Veriut pothuajse nuk shihen si kërcënime (të gjitha nën 1%), gjë që tregon për marrëdhënie përgjithësisht të qëndrueshme me këto vende.

Cilin nga vendet e Ballkanit e shihni si kërcënim për sigurinë e Shqipërisë?



Grafik 11. Opinioni mbi vendet e Ballkanit që shihen si kërcënim për sigurinë e Shqipërisë



GJEOPOLITIKA DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

GJEOPOLITIKA DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Ky kapitull shqyrton perceptimet e qytetarëve shqiptarë mbi gjeopolitikën dhe çështjet globale, duke zbuluar qëndrimet e tyre mbi aktorët kryesorë ndërkombëtarë, dinamikat e fuqive globale dhe prioritetet e politikës së jashtme. Kuptimi i këtyre qëndrimeve publike është thelbësor për përafrimin e vendimmarrjes në politikën e jashtme me pritshmëritë shoqërore, forcimin e angazhimit ndërkombëtar dhe garantimin e llogaridhënies në qeverisjen demokratike.

Influenca gjeopolitike


Ky seksion pasqyron perceptimet e publikut mbi ndikimin e aktorëve të mëdhenj globalë në Shqipëri, duke u ofruar vendimmarrësve evidenca mbi mënyrën se si qytetarët i kuptojnë dhe vlerësojnë marrëdhëniet ndërkombëtare. Kuptimi i këtyre qëndrimeve është thelbësor për të siguruar që vendimmarrja në politikën e jashtme të jetë transparente, t'i përgjigjet pritshmërive shoqërore dhe të mbështetet në llogaridhënie demokratike. Për këtë qëllim, u parashtruan pyetjet:

- Si e perceptoni ndikimin e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri?
- Si e perceptoni ndikimin e Kinës në Shqipëri?
- Si e perceptoni ndikimin e Rusisë në Shqipëri?
- Si e perceptoni ndikimin e Bashkimit European në Shqipëri?

Shtetet e Bashkuara gëzojnë një mbështetje të gjerë në Shqipëri, me një total prej **82.76%** të të anketuarve që e perceptojnë ndikimin e tyre si shumë pozitiv ose pozitiv, duke konsoliduar lidhjen e fortë transatlantike. Bashkimi European gëzon gjithashtu një nivel të lartë mbështetjeje, me **87.7%** të qytetarëve që e shohin ndikimin e tij si shumë pozitiv ose pozitiv, duke reflektuar aspiratat e forta të Shqipërisë për anëtarësim në BE.

Ndikimi i Rusisë shihet në mënyrë kritike nga një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, me një total prej **62.6%** që e konsiderojnë atë si të dëmshëm ose shumë të dëmshëm, gjë që pasqyron tensionet më të gjera gjeopolitike. Ndërkohë, opinionet mbi Kinën janë më të përmbajtura: shumica (**53.9%**) e percepton ndikimin e saj si as pozitiv, as negativ, duke sugjeruar për një qasje të kujdesshme në angazhimin me këtë aktor global.

Si mendoni se është ndikimi i SHBA-së, Kinës, Rusisë dhe BE-së ndaj Shqipërisë?



Grafik 12. Opinioni mbi ndikimin e SHBA-së, Kinës, Rusisë dhe BE-së në Shqipëri

Përdorimi i ndikimit global

Këto pyetje shqyrtojnë perceptimet e qytetarëve mbi mënyrën se si fuqitë e mëdha përdorin ndikimin e tyre global, duke ofruar të dhëna mbi nivelin besimit publik, skepticizmin ose qëndrimet ambivalent ndaj aktorëve ndërkombëtarë. Të tilla perspektiva janë të domosdoshme për të siguruar që strategjitë kombëtare të orientohen nga pikëpamjet shoqërore mbi legjitimitetin dhe besueshmërinë e fuqive globale, duke udhëhequr vendimmarrësit në përafrimin e marrëdhënieve të jashtme me pritshmëritë publike dhe vlerat demokratike. Për këtë qëllim, u parashtruan pyetjet:


- Si mendoni se SHBA e përdor aktualisht ndikimin e saj në botë?
- Si mendoni se BE e përdor aktualisht ndikimin e saj në botë?
- Si mendoni se Rusia e përdor aktualisht ndikimin e saj në botë?
- Si mendoni se Kina e përdor aktualisht ndikimin e saj në botë?

Shtetet e Bashkuara përgjithësisht shihen si një forcë pozitive, me **63.17%** të të anketuarve që besojnë se ato e përdorin kryesisht ndikimin e tyre për qëllime të pozitive, megjithëse një pjesë e konsiderueshme (**31.41%**) e pranon se ky ndikim përfshin si elementë pozitivë, ashtu edhe negativë. Bashkimi Europian gëzon edhe më shumë miratim: **77.93%** e qytetarëve besojnë se ai e përdor kryesisht ndikimin e tij për mirë, duke forcuar imazhin e tij si një aktor dashamirës në skenën ndërkombëtare.

Perceptimet mbi ndikimin global të Kinës janë më të nuancuara: **55.4%** e qytetarëve besojnë se ajo vepron si për të mirë, ashtu edhe për të keq, duke

reflektuar natyrën komplekse të rolit të saj ndërkombëtar. Në kontrast të fortë, Rusia shihet kryesisht si një aktor negativ, me **75.9%** të të anketuarve që besojnë se ajo vepron kryesisht për të keq, duke nxjerrë në pah mosbesimin e thellë ndaj agjendës së saj ndërkombëtare.

Si mendoni se këto vende e përdorin aktualisht ndikimin e tyre në mbarë botën?



Grafik 13. Opinioni mbi mënyrës se si SHBA-ja, Kina, Rusia dhe BE-ja e ushtrojnë ndikimin e tyre global

Çështjet globale dhe prioritetet e politikës së jashtme

Për të përfituar një kuptim më të thelluar mbi çështjet globale dhe përparësitë e politikës së jashtme të Shqipërisë, u shtruan pyetjet:

- Cili prej aktorëve të mëposhtëm mendoni se do të jetë më me ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare gjatë katër viteve të ardhshme?
- Me cilin nga vendet e mëposhtme mendoni se Shqipëria duhet të prioritetizojë marrëdhëniet?
- Cili prej vendeve të mëposhtme mendoni se ka marrëdhëniet më të mira me Shqipërinë?


Këto pyetje synojnë të identifikojnë pritshmëritë publike mbi dinamikat e ardhshme të fuqive globale dhe të nxjerrin në pah se cilat partneritete qytetarët besojnë se Shqipëria duhet të prioritetizojë. Të kuptuarit e këtyre qëndrimeve ndihmon për të siguruar që zgjedhjet në politikën e jashtme të pasqyrojnë preferencat shoqërore, të forcojnë besimin tek angazhimi ndërkombëtar dhe të përafrojnë prioritetet diplomatike me marrëdhëniet që publiku i konsideron më përfituese.

Një shumicë e konsiderueshme prej **68.5%** e të anketuarve parashikon Shtetet e Bashkuara si aktorin më me ndikim global në vitet në vijim, gjë që ndoshta pasqyron fuqinë e tyre ushtarake, shtrirjen ekonomike dhe praninë diplomatike. Kjo mund të reflektojë gjithashtu përafrimin strategjik të vazhdueshëm të Shqipërisë me institucionet dhe vlerat perëndimore.

Pavarësisht aspiratave të Shqipërisë për integrim në Bashkimin European, **12.6%** e qytetarëve **e shohin BE-në** si më të fokusuar tek çështjet e saj të brendshme ose të fragmentuar në rolin e saj global. Kjo mund të pasqyrojë skepticizëm mbi aftësinë e BE-së për të vepruar me vendosmëri në skenën botërore.

Ndërsa ngritja globale e **Kinës** njihet, ajo mbetet dytësore në perceptimin publik shqiptar, me vetëm **9.3% që mendojnë se do të jetë më me ndikim**. Kjo mund të lidhet me angazhimin ose dukshmërinë e kufizuar të Kinës në Shqipëri krahasuar me aktorët perëndimorë. Roli i Rusisë shihet si **margjinal (6.5%)**, ndoshta për shkak të izolimit pas pushtimit të Ukrainës dhe ndikimit të kufizuar përmes fuqisë së butë në rajon.

Cili nga aktorët e mëposhtëm mendoni se do të jetë më me ndikim në çështjet globale gjatë 4 viteve të ardhshme?




Grafik 14. Opinioni mbi aktorët më me ndikim në çështjet globale gjatë 4 viteve të ardhshme

Marrëdhëniet me të mira me shtetet

Italia perceptohet nga **(34.8%)** e të qytetarëve të pyetur si vendi me marrëdhëniet më të mira me Shqipërinë, ç'ka pasqyron lidhjet e thella historike, kulturore dhe ekonomike mes dy vendeve. Migracioni, tregtia dhe afërsia gjeografike ka të ngjarë të forcojnë më tej perceptimin e saj si partner strategjik. Shtetet e Bashkuara renditen menjëherë pas Italisë **(29.9%)**, pasi qytetarët shqiptarë i shohin ato si një aleat kyç për sigurinë, investimet dhe pozicionimin global të vendit.

Pavarësisht rolit të saj drejtues në BE dhe kontributit si donator i rëndësishëm, Gjermania renditet në mënyrë modeste (**6.0%**), ndoshta për shkak të angazhimit më pak të drejtpërdrejtë ose dukshmërisë më të kufizuar në diskursin publik shqiptar. Roli i Francës në çështjet e BE-së njihet, por nuk perceptohet si qendror për strategjinë dypalëshe të Shqipërisë. Nga ana tjetër, roli i Turqisë si fuqi rajonale dhe afërsia kulturore mund të shpjegojnë përqindjen e saj relativisht të lartë (**16.6%**), duke sugjeruar një qasje pragmatike të qytetarëve shqiptarë ndaj partneriteteve rajonale.

Me cilin nga vendet e mëposhtme i ka aktualisht Shqipëria marrëdhëniet më të mira?




Grafik 15. Opinioni mbi vendet me marrëdhëniet më të mira me Shqipërinë

Për shumicën e të anketuarve (**40.8%**), Shtetet e Bashkuara përfaqësojnë vendin me të cilin Shqipëria duhet të ndërtojë marrëdhënie sa më të ngushta në të ardhmen. Ky rezultat reflekton besimin e lartë tek roli i SHBA-së si partner strategjik në siguri, qeverisje dhe luftën kundër korrupsionit. Gjermania renditet në vendin e dytë me **14.9%**, duke treguar se qytetarët e shohin atë si aktor me rëndësi për ekonominë dhe politikën evropiane, edhe pse jo në të njëjtat nivele prioritare si SHBA.

Greqia zë vendin e tretë me **10.3%**, ku perceptimet lidhen kryesisht me marrëdhëniet tregtare, migracionin dhe stabilitetin rajonal. Mbretëria e Bashkuar përmendet nga **9%** e të anketuarve, duke pasqyruar lidhjet e

diasporës dhe mbështetjen zhvillimore, ndërsa Franca, me **6.1%**, shihet si një partner i qëndrueshëm, por pa një rol të spikatur në prioritetet e ardhshme.

Me cilin nga vendet e mëposhtme mendoni se duhet t'i ketë Shqipëria marrëdhëniet më të mira në të ardhmen?



Grafik 16. Opinioni mbi vendet prioritare për marrëdhëniet e Shqipërisë

Shteti	Duhet të prioritarizojë marrëdhëniet (%)	Marrëdhëniet më të mira momentalisht (%)	Interpretimi i mospërputhjes
Italia	6.81	34.75	Perceptohet si vendi me marrëdhëniet më të mira aktualisht, por nuk shihet prioritet për të ardhmen. Qytetarët janë të kënaqur me gjendjen ekzistuese dhe nuk kërkojnë përparësi shtesë.
SHBA	40.83	29.86	Shihet si partneri që duhet të ketë prioritet në të ardhmen, edhe pse marrëdhëniet aktuale janë të forta. Pasqyron pritshmëri për thellim të mëtejshëm strategjik.

Turqia	3.96	16.60	Marrëdhëniet aktuale perceptohen më të forta sesa nevoja për priorizim në të ardhmen. Sugjeron qasje pragmatike dhe më rezervuar ndaj rolit afatgjatë të Turqisë.
Gjermania	14.89	6.00	Edhe pse nuk perceptohet si partner i afërt aktualisht, një pjesë e mirë e qytetarëve e konsideron prioritet për të ardhmen, për shkak të peshës ekonomike dhe politike në BE.
Franca	6.05	5.03	Diferencë e vogël mes perceptimit aktual dhe pritshmërive për të ardhmen. Tregon stabilitet, por jo rol të spikatur në agjendën bilaterale të Shqipërisë.
Greqia	10.28	0.59	Marrëdhëniet aktuale perceptohen më të rëndësishme se nevoja për t'i prioritetizuar në të ardhmen. Pasqyron bashkëpunim praktik (emigracion, tregti, stabilitet rajonal), por mungesë vizioni strategjik afatgjatë.

Tabela 2: Analiza e mospërputhjeve midis përparësive të politikës së jashtme dhe marrëdhënieve më të mira

Marrëdhëniet transatlantike dhe organizatat ndërkombëtare


Ky seksion ofron një panoramë mbi mënyrën se si qytetarët perceptojnë arkitekturën e sigurisë së Shqipërisë, aleancat ndërkombëtare dhe angazhimet shumëpalëshe. Duke matur pritshmëritë e qytetarëve mbi marrëdhëniet transatlantike dhe rëndësinë e organizatave si NATO, BE, OSBE dhe OKB, vendimmarrësit mund të përafrojnë strategjitë e sigurisë kombëtare dhe të politikës së jashtme me prioritetet publike.

Për të marrë këto të dhëna, u parashtruan pyetjet:

- Sa e rëndësishme është NATO për sigurinë kombëtare të Shqipërisë?
- Sa e rëndësishme është BE për sigurinë kombëtare të Shqipërisë?
- Sa e rëndësishme është OSBE për sigurinë kombëtare të Shqipërisë?
- Sa e rëndësishme është OKB për sigurinë kombëtare të Shqipërisë?
- Me cilën nga këto organizata ndërkombëtare Shqipëria duhet të prioritetizojë marrëdhëniet?
- Në pesë vitet e ardhshme, si parashikoni të jenë marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara dhe Evropës?

Rëndësia e NATO-s për sigurinë e Shqipërisë është pothuajse unanime, me **98.84%** të të anketuarve që e konsiderojnë të rëndësishme, duke theksuar rolin qendror të aleancës në mbrojtjen kombëtare të vendit. Bashkimi Evropian shihet gjithashtu si kritik për sigurinë e Shqipërisë, me **94.9% që e konsiderojnë të rëndësishëm**, duke vënë në dukje rolin e BE-së në dimensionet më të gjera të sigurisë. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) gëzojnë gjithashtu një vlerësim të fortë, me përkatësisht **81.4% dhe 81.2% të qytetarëve që i konsiderojnë të rëndësishme**. Këto perceptime nënvizojnë rëndësinë e angazhimit të vazhdueshëm të Shqipërisë ndaj këtyre organizatave dhe të pjesëmarrjes aktive në veprimtaritë e tyre.

Sa të rëndësishme janë këto organizata për sigurinë kombëtare të Shqipërisë?



Grafik 17. Opinioni mbi rëndësinë së organizatave ndërkombëtare për sigurinë kombëtare të Shqipërisë


Kur u pyetën se me cilat organizata ndërkombëtare vendi duhet të prioritetizojë marrëdhëniet në politikën e jashtme, **57.7%** e të anketuarve identifikuan Bashkimin Evropian si zgjedhjen kryesore, të ndjekur nga **39.0%** që favorizuan NATO-n. Në kontrast të fortë, vetëm 1.8% zgjodhën Kombet e Bashkuara, 1.4% Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, dhe vetëm 0.2% nuk ishin të sigurt, duke nënvizuar qartësinë dhe vendosmërinë e opinionit publik.

Këto të dhëna tregojnë se qytetarët shqiptarë në masë dërrmuese e shohin integrimin në BE si gurthemel të së ardhmes së vendit. BE-ja perceptohet jo vetëm si një rrugë drejt zhvillimit ekonomik dhe reformës institucionale, por edhe si simbol i vlerave demokratike, sundimit të ligjit dhe stabilitetit rajonal.

Mbështetja e gjerë për NATO-n thekson më tej angazhimin strategjik të Shqipërisë ndaj mbrojtjes kolektive dhe aleancave perëndimore. Me **39%** të të anketuarve që e prioritetizojnë NATO-n, bëhet e qartë se qytetarët vlerësojnë “ombrellën e sigurisë” që ofron aleanca, veçanërisht në kushtet e tensioneve gjeopolitike në Evropën Lindore dhe Ballkanin Perëndimor. NATO perceptohet jo vetëm si një aleancë ushtarake, por edhe si garant i sovranitetit dhe paqes rajonale.

Ndërkohë, prioritetizimi i ulët i OKB-së dhe OSBE-së sugjeron se institucionet shumëpalëshe me **mandate më të gjera ose më teknike shihen si më pak të lidhura drejtpërdrejt** me prioritetet afatshkurtra të Shqipërisë. Megjithëse këto organizata luajnë role të rëndësishme në qeverisjen globale dhe demokratizim, prania e tyre dhe ndikimi që publiku u atribuon në çështjet e brendshme duken të kufizuara.

Marrëdhënien me cilën nga organizatat ndërkombëtare duhet ta ketë si prioritet kryesor Shqipëria në 4 vitet e ardhme?




Grafik 18. Opinioni mbi organizatat ndërkombëtare prioritare për marrëdhëniet e Shqipërisë

Marrëdhëniet SHBA-BE

Të dhënat zbulojnë një ndjenjë mbizotëruese optimizmi mes qytetarëve shqiptarë lidhur me të ardhmen e marrëdhënieve transatlantike. Kur u pyetën se si e parashikojnë zhvillimin e marrëdhënieve midis Shteteve të Bashkuara dhe Evropës gjatë pesë viteve të ardhshme, **54.7%** e të anketuarve thanë se presin një afrimitet më të madh, ndërsa **34.6%** besojnë se ato do të mbeten përafërsisht të njëjta. Vetëm **8.6%** parashikojnë një marrëdhënie më të largët dhe vetëm **2.1%** shprehën pasiguri, çka tregon se qytetarët janë të interesuar dhe kanë një qëndrim të qartë për këtë çështje.

Në pesë vitet e ardhshme, si parashikoni të jenë marrëdhëniet midis Shteteve të Bashkuara dhe Evropës?



Grafik 19. Opinioni mbi marrëdhëniet SHBA–BE në pesë vitet e ardhshme



**ANËTARËSIMI NË
BASHKIMIN EVROPIAN**

ANËTARËSIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN


Ky kapitull shqyrton qëndrimin e opinionit publik në Shqipëri mbi anëtarësimin në Bashkimin Evropian, një çështje me rëndësi të madhe kombëtare. Analiza eksploron si vlerën e perceptuar të integritit në BE, ashtu edhe pritshmëritë për afatin kohor të anëtarësimit të Shqipërisë, duke u ofruar vendimmarrësve të dhëna të vlefshme mbi mbështetjen dhe prioritetet e publikut. Të kuptuarit nëse njerëzit e shohin anëtarësimin në BE si të dobishëm u jep vendimmarrësve një tregues të qartë mbi nivelin e mbështetjes për integrit. Ndërkohë, të kuptuarit se çfarë përfaqëson BE-ja për individët në nivel personal, ndihmon të identifikohen faktorët kryesorë, të cilët mund të përdoren për të orientuar komunikimin me publikun dhe përcaktimin e prioritetëve politike. Të marra së bashku, këto pyetje synojnë të matin nëse procesi i politikëbërjes për anëtarësimin në BE mbetet i përafruar me pritshmëritë, vlerat dhe shqetësimet e publikut, të cilat janë të rëndësishme për llogaridhënien dhe legjitimitetin e procesit.

Për të marrë këto të dhëna u parashtruan pyetjet:

- *Si e konsideroni anëtarësimin e Shqipërisë në BE?*
- *Çfarë do të thotë BE për ju personalisht? (Zgjedhja e parë)*
- *Përveç asaj që thatë më parë, çfarë do të thotë BE për ju personalisht? (Zgjedhja e dytë)*
- *A jeni të bindur se Shqipëria do të bëhet anëtare e BE-së deri në vitin 2030?*

Anëtarësimi në BE shihet në mënyrë dërrmuese si dobishëm, me **86.9%** të të anketuarve që besojnë se do të ishte një gjë e mirë, duke treguar një mbështetje të gjerë popullore për integritin evropian. Kjo mbështetje për anëtarësimin në BE nënkupton një konsensus kombëtar të fuqishëm mbi orientimin strategjik të Shqipërisë drejt Evropës.

Si mendoni se do të ishte anëtarësimi i Shqipërisë në BE?



Grafik 20. Opinioni mbi anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian

Përgjigjet ndaj pyetjes “Çfarë do të thotë BE për ju personalisht?” zbulojnë një narrativë njëkohësisht të fuqishme dhe aspiruese mes qytetarëve shqiptarë. Të dhënat tregojnë se mirëqenia ekonomike (**32.3%**) dhe liria për të udhëtuar, studiuar dhe punuar kudo në BE (**31.9%**) janë dy përfytyrimet personale më të forta me Bashkimin Evropian. Këto gjetje tregojnë se qytetarët shqiptarë e shohin BE-në jo thjesht si një ent politik, por si një portë drejt mundësive, lëvizshmërisë dhe përmirësimit të cilësisë së jetës.


Për shumë shqiptarë, BE përfaqëson një premtim për mobilitet social – qasje në punësim, arsim dhe horizonte më të gjera përtej kufijve kombëtarë. Kjo është veçanërisht e domethënëse tek të rinjtë dhe profesionistët, të cilët e shohin integrimin si një rrugë drejt zhvillimit personal dhe profesional. Theksi i fortë mbi përfitimet ekonomike nënvizon gjithashtu pritshmëritë e publikut për përmirësime konkrete në standardet e jetesës, infrastrukturë dhe mundësi punësimi përmes përafrimit me BE-në.

Përtej aspiratave materiale, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve e lidhin BE-në me **demokracinë (12.4%) dhe paqen (11.7%)**. Këto vlera pasqyrojnë aspirata më të thella për llogaridhënie institucionale, sundim të ligjit dhe stabilitet rajonal. Edhe pse nuk renditen në krye, ato mbeten pjesë qendrore e tërheqjes simbolike të BE-së, veçanërisht mes atyre të angazhuar në reformat e qeverisjes dhe fuqizimit qytetar.

Interesante është fakti se **mbrojtja sociale (5.3%)** u shfaq më e theksuar si zgjedhje e dytë (12.7%), duke sugjeruar se, edhe pse nuk është zgjedhja e parë, shumë shqiptarë vlerësojnë modelin përfshirës të mirëqenies të BE-së dhe theksin e saj mbi barazinë dhe mbështetjen për grupet vulnerabël.

Nga ana tjetër, **lidhjet negative me BE-në janë marginale**. Vetëm përqindje të vogla të të anketuarve e lidhën BE-në me shqetësime si humbja e identitetit kulturor (**1.4%**), mungesa e kontrollit të kufijve (**1.3%**), burokracia (**0.7%**) ose shpërdorimi i parave (**0.8%**). Këto shifra sugjerojnë se skepticizmi ekziston, por nuk është i përhapur. Megjithatë, ato nënvizojnë rëndësinë e adresimit të frikërave rreth sovranitetit, erozionit kulturor dhe kompleksitetit institucional – veçanërisht në rajone ose segmente demografike më të ndjeshme ndaj dezinformimit ose mungesës së përfshirjes.

Çfarë do të thotë Bashkimi Evropian për ju personalisht?



Grafik 21. Opinioni personal mbi kuptimin e Bashkimit Evropian

Në përgjithësi, të dhënat paraqesin një shoqëri thellësisht aspiruese, kryesisht optimiste dhe gjerësisht të përafruar me vlerat dhe përfitimet thelbësore të BE-së. Për vendimmarrësit, aktorët e shoqërisë civile dhe komunikuesit, kjo ofron një mandat të qartë: të forcohet roli i BE-së si motor i prosperitetit dhe mundësive, duke ushqyer njëkohësisht vlerat demokratike dhe duke adresuar shqetësimet e mbetura përmes transparencës dhe përfshirjes.

Megjithatë, përgjigjet e anketës zbulojnë një optimizëm të matur mes qytetarëve shqiptarë në lidhje me rrugën e vendit drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Kur u pyetën nëse besojnë se Shqipëria do të bëhet anëtare e BE-së deri në vitin 2030, **43.1%** u përgjigjën “Po” dhe **21.5%** thanë “Anoj nga Po”. Së bashku, pothuajse dy të tretat e të anketuarve (**64.6%**) shprehin besim ose optimizëm të matur se anëtarësimi do të ndodhë brenda pesë viteve të ardhshme.


Ky perceptim nga shumica pasqyron një besim të qëndrueshëm publik tek procesi i integritetit në BE, pavarësisht kompleksitetit dhe vonesave të tij. Ai sugjeron se shumica e shqiptarëve vazhdojnë ta shohin anëtarësimin si të arritshëm dhe të dëshirueshëm, sepse qytetarët presin përfitime nga rritja ekonomike, reformat demokratike dhe stabiliteti rajonal.

Të dhënat zbulojnë gjithashtu një prirje të ndjeshme skepticizmi. **18.9%** u përgjigjën “Anoj nga Jo” dhe **13.7%** thanë “Jo”, duke treguar se gati një e treta e popullsisë ka dyshime mbi aftësinë e Shqipërisë për të përmbushur kriteret e anëtarësimit ose për të kapërcyer pengesat politike dhe institucionale deri në vitin 2030. Kjo kategori mund të ndikohet nga progresi i ngadaltë në reformat kyçe, mungesa e vullnetit politik ose nga zhgënjimi më i gjerë ndaj ritmit të zgjerimit të BE-së.


Për të kuptuar më mirë këto dyshime, të anketuarit që iu përgjigjën “Jo” ose “Anoj nga Jo” u pyetën të vlerësonin kur – nëse ndonjëherë – besojnë se Shqipëria do të anëtarësohet në BE. Mes tyre, **11.2%** presin anëtarësim brenda 10 vitesh, **10.8%** brenda 15 vitesh, dhe **6.1%** brenda 20 vitesh. Domethënës është fakti se **4.5%** besojnë se Shqipëria nuk do të anëtarësohet kurrë, ndërsa **2.9%** janë të pasigurt. Këto përgjigje sugjerojnë se edhe mes skepticëve, shumë e shohin ende anëtarësimin si një mundësi afatgjatë, dhe jo si një pamundësi absolute.

Megjithatë, shifra më domethënëse është se **64.6%** e të gjithë të anketuarve nuk dhanë përgjigje për këtë pyetje, pasi nuk kishin shprehur në pyetjen e mëparshme një qëndrim negativ (“Jo” ose “Anoj nga Jo”). Kjo përforcon gjetjen e mëparshme: një shumicë e qartë e shqiptarëve mbeten shpresëplotë ose të bindur se anëtarësimi në BE është në horizont dhe se nuk pritet të ketë vonesa të zgjatura.

A keni besim se Shqipëria do të jetë anëtare e BE-së në vitin 2030?



Për sa vite mendoni se Shqipëria do të bëhet anëtare e BE-së?



Grafik 22 dhe 23. Opinioni mbi anëtarësimin e Shqipërisë në BE deri në vitin 2030 dhe opinioni mbi afatin kohor të anëtarësimit të Shqipërisë në BE



KRIMI I ORGANIZUAR: PERCEPTIME DHE QËNDRIME

KRIMI I ORGANIZUAR: PERCEPTIME DHE QËNDRIME

Ky kapitull përqendrohet në krimin e organizuar në Shqipëri, duke e parë nga perspektiva e qytetarëve. Është hera e parë që qytetarët shqiptarë anketohen drejtpërdrejt mbi këtë temë. Pyetjet e parashtruara synuan të pasqyrojnë perceptimet, përvojat dhe qëndrimet e qytetarëve lidhur me: **seriozitetin e problemit të krimit të organizuar, natyrën e aktiviteteve, faktorët që kontribuojnë në krimin e organizuar, shkallën dhe ndikimin e tij brenda komuniteteve dhe në mbarë vendin, ndikimin e krimit të organizuar mbi politikën dhe veçanërisht mbi zgjedhjet, si dhe mbi ekonominë.** Për më tepër, pyetjet synuan të kapin edhe perceptimin për efektivitetin e përpjekjeve institucionale për të luftuar krimin e organizuar dhe nivelin e besimit tek institucionet e zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë.

Serioziteti dhe aktivitetet e krimit të organizuar

Një nga pyetjet themelore në vlerësimin e ndikimit të krimit të organizuar është të kuptuarit se sa seriozisht e percepton publiku këtë çështje. Perceptimi publik formëson qëndrimet ndaj forcave të rendit, politikave qeveritare dhe gatishmërinë për t'u angazhuar në përpjekjet kundër krimit. Kjo pjesë analizon rezultatet e anketës që lidhen drejtpërdrejt me seriozitetin e perceptuar të krimit të organizuar në Shqipëri, si në nivel kombëtar ashtu edhe lokal.

Pyetjet e parashtruara ishin:

- *Sa serioz mendoni se është problemi i krimit të organizuar në qytetin/qarkun tuaj?*
- *Sa serioz mendoni se është problemi i krimit të organizuar në Shqipëri?*
- *Në cilin qark të Shqipërisë mendoni se krimi i organizuar ushtron më shumë ndikim?*
- *Sipas jush, cili është aktiviteti kryesor me të cilin merret krimi i organizuar?*
- *Sipas jush, cilat janë aktivitetet e dyta më kryesore me të cilat merret krimi i organizuar?*
- *Sipas mendimit tuaj, kultivimi i kanabisit në tre vitet e fundit në Shqipëri ka...*
- *A pajtoheni se kultivimi i kanabisit ka ndikuar në zgjerimin e shkallës së pranisë së krimit të organizuar në Shqipëri?*
- *A pajtoheni se legalizimi i kultivimit të kanabisit do të reduktonte përfshirjen e krimit të organizuar në kultivimin e kanabisit në Shqipëri?*

Rezultatet e anketës zbulojnë një ndarje të dukshme mes mënyrës se si qytetarët e shohin problemin në nivel kombëtar krahasuar me atë lokal. Ndërsa shumica e të anketuarve – **59.2%** – e konsiderojnë krimin e organizuar një problem shumë serioz në rang vendi, vetëm **27.4%** ndajnë të njëjtin mendim për qytetin apo qarkun e tyre. Ky kontrast sugjeron një distancim si psikologjik, ashtu edhe hapësinor, ku kërcënimi pranohet në plan të gjerë, por nuk perceptohet domosdoshmërisht si i pranishëm në mjedisin e përditshëm.


Në nivel lokal, gjysma e popullsisë (**50.2%**) beson se krimi i organizuar *nuk është shumë serioz*, dhe një shifër e lartë prej **22.1%** – shkon deri aty sa të thotë se *nuk është aspak serioz*. Këto shifra bien ndesh me perceptimin kombëtar, ku vetëm **39.0%** e shohin problemin si *jo shumë serioz* dhe vetëm **1.4%** e mohojnë plotësisht ekzistencën e tij. Një hendek i tillë mund të pasqyrojë disa dinamika: natyrën e fshehtë të krimit të organizuar, varietete rajonale të aktivitetit kriminal, ose edhe një normalizim të praktikave të paligjshme, të cilat nuk perceptohen më si kërcënime nga komunitetet lokale.

Interesant është fakti se pasiguria pothuajse nuk ekziston. Vetëm **0.2%** e të anketuarve kanë deklaruar se nuk ishin të sigurt mbi seriozitetin e krimit të organizuar në zonën e tyre, dhe vetëm **0.4%** në nivel kombëtar. Kjo tregon se qytetarët shqiptarë ndihen të bindur në vlerësimet e tyre, qofshin ato të ndikuara nga përvoja personale, nga narrativat mediatike apo nga diskursi publik.

Të marra së bashku, këto gjetje nxjerrin në pah një sfidë të ndërlikuar për vendimmarrësit dhe aktorët e shoqërisë civile. Ndërsa shqetësimi kombëtar është i qartë, mungesa e perceptimit të urgjencës në nivel lokal mund të pengojë mobilizimin komunitar, raportimin dhe përpjekjet parandaluese të bazuara në komunitet. Për të kapërcyer këtë hendek perceptimi, kërkojë komunikim strategjik, angazhim i lokalizuar dhe më shumë transparencë në veprimtarinë e zbatimit të ligjit, në mënyrë që qytetarët jo vetëm ta njohin problemin, por edhe të ndihen të fuqizuar për ta adresuar atë brenda komuniteteve të tyre.

Dallimi mes perceptimeve kombëtare dhe atyre lokale është një gjetje thelbësore. Ai tregon rëndësinë e **medias dhe narrativave kombëtare**: njerëzit ka gjasa të ndikohen nga raportimet dhe diskutimet në nivel kombëtar mbi krimin e organizuar, çka çon në perceptim më të lartë të seriozitetit në nivel vendi. Po ashtu, kjo sugjeron se **realitetet lokale mund të ndryshojnë**: përgjigjet e lokalizuara tregojnë se përvoja reale me krimin e organizuar mund të ndryshojë ndjeshëm nga një rajon në tjetrin. Në disa zona, ndikimi mund të jetë më i ulët, ose format e krimit të pranishëm perceptohen si më pak kërcënuese. Përqindja relativisht e lartë e qytetarëve që nuk e shohin krimin e organizuar si problem serioz në zonën e tyre mund të **sjellë vetëkënaqësi dhe një gatishmëri më të ulët** për të mbështetur nisma lokale kundër krimit.

Sa serioz e konsideroni problemin e krimit të organizuar në Shqipëri dhe në qytetin/bashkinë ku banoni?




Grafik 24. Opinioni mbi seriozitetin e krimit të organizuar në Shqipëri dhe në nivel lokal

Kur u pyetën se cili qark i Shqipërisë është më i prekur nga krimi i organizuar, **Shkodra** doli si përgjigjja dominuese, e përmendur nga **27.8%** e të anketuarve. Pas saj renditen **Elbasani (18.7%)** dhe **Lezha (17.3%)**, duke sugjeruar se veriu dhe qendra e vendit perceptohen si vatra kryesore të rrjeteve kriminale. Ndërkohë, pavarësisht rëndësisë së tyre ekonomike dhe logjistike, **Durrësi (9.4%)** dhe **Tirana (9.3%)** u përmendën shumë më pak. Ky kontrast mund të reflektojë perceptimin se aktiviteti kriminal në këto qendra urbane është më i fshehur ose më i institucionalizuar.

Rajone si **Gjirokastra (0.2%)**, **Korça (0.4%)** dhe **Dibra (0.7%)** u përmendën shumë rrallë, gjë që mund të tregojë ose një dukshmëri më të ulët të krimit të organizuar, ose bindjen publike se këto zona janë më pak të prekura. Interesant është fakti se **asnjë i anketuar** nuk zgjodhi opsionin “Nuk jam i sigurt”, duke treguar një nivel të lartë besimi ose familjariteti me dinamikat rajonale të krimit.

Në cilin qark të Shqipërisë mendoni se krimi i organizuar ka më shumë ndikim?



Grafik 25. Opinioni mbi qarkun me ndikimin më të madh të krimit të organizuar në Shqipëri


Aktivitetet e Krimit të Organizuar

Të kuptuarit e aktiviteteve specifike me të cilat merren grupet e krimit të organizuar është thelbësor për hartimin e strategjive efektive që synojnë prishjen e operacioneve dhe çmontimin e rrjeteve të tyre. Për këtë arsye, anketa përfshiu pyetje të posaçme për të identifikuar aktivitetet që publiku shqiptar i percepton si më të përhapura dhe më domethënëse.

Të dhënat tregojnë se, në aspektin e operacioneve kriminale, **trafikimi i drogës** shihet në mënyrë dërmuese si aktiviteti kryesor i krimit të organizuar: **47.1%** e identifikojnë atë si shqetësimin kryesor, ndërsa **22.4%** e listojnë si aktivitetin e dytë më të zakonshëm. Ky perceptim përkon me rolin e njohur të Shqipërisë si nyje tranziti dhe prodhimi në rrugët rajonale të narkotikëve. Pas tij renditet **pastrimi i parave**, i përmendur nga **25.6%** si aktiviteti kryesor dhe nga **30.8%** si aktiviteti i dytë më i shpeshtë. Ky fakt pasqyron ndërgjegjësimin e publikut mbi mënyrat se si fitimet e paligjshme integrohen në ekonominë formale, shpesh përmes sektorëve të pasurive të paluajtshme, ndërtimit ose kompanive fiktive. **Vrasjet dhe krimet e dhunshme** shfaqen gjithashtu në mënyrë të dukshme: **17.3%** i rendisin si aktivitet kryesor dhe **20.1%** si aktivitet dytësor, duke

theksuar perceptimin mbi brutalitetin dhe mekanizmat e dhunshëm të zbatimit brenda grupeve kriminale. Aktivitete të tjera, si **lojërat e paligjshme të fatit, zhvatja e parave, prostitucioni dhe vjedhjet e pronës**, u përmendën shumë më rrallë, gjë që sugjeron se shihen ose si periferike, ose si më pak të dukshme. **Trafikimi i qenieve njerëzore**, pavarësisht afërsisë së Shqipërisë me rrugët e migracionit, u përmend nga vetëm **1.0%** si aktivitet kryesor. Vlen të theksohet se mungesa pothuajse totale e përgjigjeve “Nuk jam i sigurt” në të dyja pyetjet tregon se qytetarët shqiptarë ndihen të informuar dhe të sigurt në vlerësimet e tyre për krimin e organizuar qoftë këto të formësuara nga media, përvoja personale apo diskursi publik.

Cilat mendoni se janë veprimtaritë kryesore të krimit të organizuar?



Grafik 26. Opinioni mbi veprimtaritë kryesore të krimit të organizuar në Shqipëri


Aktiviteti i kultivimit të kanabisit

Kultivimi dhe trafikimi i kanabisit kanë qenë ndër aktivitetet e para dhe më të përhapura të grupeve kriminale në Shqipëri që prej tranzicionit post-komunist. Klima e favorshme e vendit, kushtet e vështira ekonomike dhe dobësia e zbatimit të ligjit kontribuan në shndërrimin e Shqipërisë në një prodhues të rëndësishëm

të kanabisit, kryesisht për tregjet europiane. Ky aktivitet i paligjshëm është ndërthurur ngushtë me krimin e organizuar, duke i siguruar grupeve kriminale një burim të ardhurash shumë fitimprurëse dhe duke nxitur korrupsion, dhunë dhe paqëndrueshmëri institucionale. Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për të frenuar kultivimin dhe trafikimin, problemi mbetet një sfidë serioze, duke nxitur debate të vazhdueshme mbi efektivitetin e politikave aktuale dhe mbi mundësinë e qasjeve alternative, si legalizimi apo dekriminalizimi. Për këtë arsye, pyetjet mbi kultivimin e kanabisit janë thelbësore për të kuptuar ndërveprimin kompleks mes prodhimit të drogës, krimit të organizuar dhe opsioneve të mundshme të politikave publike.

Kur u pyetën për ecurinë e kultivimit të kanabisit gjatë tre viteve të fundit, qytetarët rezultuan të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë: **36.4%** besojnë se niveli i kultivimit ka mbetur i njëjtë, ndërsa **36.0%** mendojnë se ka rënë. Ndërkohë, **25.6%** perceptojnë një rritje, duke sugjeruar se një pakicë domethënëse ende e sheh kanabisin si një shqetësim në rritje. Kjo shpërndarje perceptimesh pasqyron ndryshimet rajonale në dukshmërinë e fenomenit, ashtu edhe në zbatimin e ligjit, si dhe nivelet e ndryshme të ekspozimit të publikut ndaj aktivitetit të kultivimit.

Sipas mendimit tuaj, kultivimi i kanabisit në tre vitet e fundit në Shqipëri është:




Grafik 27. Opinioni mbi nivelin e kultivimit të kanabisit në Shqipëri gjatë tre viteve të fundit

Një shumicë e dukshme e qytetarëve shqiptarëve **49.3%** plotësisht dakord dhe **39.9%** pjesërisht dakord – beson se kultivimi i kanabisit ka kontribuar në zgjerimin e krimit të organizuar. Ky konsensus i gjerë prej **89.2%** thekson bindjen e publikut se ekonomia e kanabisit nuk është thjesht një çështje bujqësore, por një portë hyrëse për veprimtari të tjera kriminale. Qoftë përmes rrjeteve të trafikut, pastrimit të parave apo korrupsionit në organet e rendit, kanabisi shihet si një mundësues strukturor i krimit të organizuar.

Ky perceptim përkon me hetimet dhe proceset gjyqësore, të cilat kanë zbuluar përfshirjen e policisë, mbrojtjen politike të zonave të kultivimit dhe përdorimin e fitimeve nga kanabisi për të financuar aktivitete të tjera të paligjshme. Përqindja e vogël e atyre që nuk bien dakord (10.1% në total, duke kombinuar përgjigjet “Anoj nga Jo” dhe “Jo”) sugjeron se skepticizmi mbi këtë lidhje është i rrallë dhe ka gjasa të jetë i përqendruar në demografi ose rajone specifike.

A jeni dakord që kultivimi i kanabisit ka ndikuar në zgjerimin e shkallës së pranisë së krimit të organizuar në Shqipëri?




Grafik 28. Opinioni mbi ndikimin e kultivimit të kanabisit në zgjerimin e krimit të organizuar në Shqipëri

Opinionet mbi pyetjen nëse legalizimi i kultivimit të kanabisit do të ulte krimin e organizuar janë dukshëm më të ndara. Vetëm 17.2% e mbështesin fort legalizimin si strategji për reduktimin e krimit, ndërsa 32.7% shprehen pjesërisht pro. Pra, pothuajse gjysma e të anketuarve 49.9% tregojnë një optimizëm të kujdesshëm mbi këtë çështje. Nga ana tjetër, 47.5% shprehin skepticizëm – 24.6% janë pjesërisht kundër dhe 22.9% e refuzojnë plotësisht idenë – duke treguar qëndrim të dyzuar mbi efektivitetin e legalizimit për të frenuar përfshirjen kriminale.

Ky polarizim pasqyron tensionet më të gjera në diskursin publik: disa e shohin legalizimin si mjet për të rregulluar dhe dekriminalizuar tregun, ndërsa të tjerë frikësohen se mund të legjitimojë rrjetet kriminale ekzistuese ose të mos arrijnë të çmontojë sistemet e rrënjosura të korrupsionit. Përqindja e vogël e të pasigurtëve (2.5%) mund të lidhet me pritjen për të parë se si do të zhvillohet legalizimi në vende të tjera, ose me dyshimin mbi aftësinë e institucioneve shqiptare për të menaxhuar një tranzicion të tillë.

A jeni dakord që legalizimi i kultivimit të kanabisit do të ulë përfshirjen e krimit të organizuar në kultivimin e kanabisit në Shqipëri?



Grafik 29. Opinioni mbi ndikimin e legalizimit të kultivimit të kanabisit në përfshirjen e krimit të organizuar

Faktorët dhe shkaqet kryesore që kontribuojë në krimin e organizuar

Për t'u zhvilluar në mënyrë efektive, lufta kundër krimit të organizuar, kërkon një kuptim të thellë të faktorëve që mundësojnë shfaqjen, qëndrueshmërinë dhe zgjerimin e tij. Këta faktorë mund të ndahen gjerësisht në socio-ekonomikë, politikë, institucionalë dhe kulturorë. Ky seksion analizon të dhënat e anketës mbi perceptimet e publikut për shkaqet kryesore dhe faktorët kontribues të krimit të organizuar në Shqipëri.

Për këtë qëllim, u parashtruan pyetjet:


- Sa e konsideroni papunësinë si shkak të rëndësishëm për përfshirjen në krimin e organizuar në Shqipëri?
- Sa e konsideroni varfërinë si shkak të rëndësishëm për përfshirjen në krimin e organizuar në Shqipëri?
- Sa e konsideroni marrëdhëniet ose problemet prindërore si shkak për përfshirjen e të rinjve në krim në Shqipëri?
- Sa i konsideroni dënimet e buta ndaj kriminelëve si shkak të pranisë së krimit të organizuar në Shqipëri?
- Sa i konsideroni lidhjet mes politikës dhe krimit të organizuar si shkak të pranisë së krimit të organizuar në Shqipëri?
- Sa e konsideroni korrupsionin si shkak të pranisë së krimit të organizuar në Shqipëri?
- Sa e konsideroni veprimtarinë e vetë grupeve kriminale si faktor për përfshirjen e qytetarëve në aktivitete të krimit të organizuar?

Faktorët socialë

Perceptimet publike në Shqipëri tregojnë një konsensus të fortë rreth faktorëve socio-ekonomikë dhe familjarë si nxitës të krimit të organizuar, veçanërisht mes të rinjve. Të dhënat paraqesin një tablo të dobësive strukturore, ku papunësia, varfëria dhe marrëdhëniet e tensionuara prindërore shihen si katalizatorë kryesorë për përfshirjen në aktivitete kriminale.

Shumica e të anketuarve (**53.7%**) besojnë se papunësia është një *shkak shumë i rëndësishëm* për përfshirjen në krimin e organizuar, ndërsa **34.0%** e konsiderojnë atë *disi të rëndësishme*. Ky total prej **87.7%** reflekton një vetëdije të gjerë se mungesa e mundësive ekonomike ushqen dëshpërimin dhe nxit aktivitetin e paligjshëm. Vetëm **1.9%** e hedhin poshtë papunësinë si faktor, duke treguar se lidhja mes mungesës së punës dhe krimit është e ngulitur thellë në vetëdijen publike. Ky perceptim lidhet ngushtë me papunësinë e vazhdueshme të të rinjve, pabarazitë rajonale, si dhe mungesën e aksesit në punë dinjitoze, veçanërisht në zonat ku krimi i organizuar ofron burime alternative të të ardhurave.


Sa mendoni se ndikon papunësia në përfshirjen e shqiptarëve në krimin e organizuar?



Grafik 30. Opinioni mbi rëndësinë e papunësisë si shkak për përfshirjen në krimin e organizuar

Varfëria shihet si një nxitës edhe më i fuqishëm sesa papunësia. **58.1%** e shqiptarëve mendojnë se ajo luan një *rol kryesor* në shtyrjen e individëve drejt krimit të organizuar, ndërsa **31.2%** e konsiderojnë *disi të rëndësishme*. Me një total prej **89.3%** që e pranojnë ndikimin e saj, varfëria del si shkak struktural më gjerësisht i pranuar. Kjo tregon se, përtej mungesës së punës, kushtet më të gjera të privimit, si strehimi i pamjaftueshëm, arsimi i dobët dhe mungesa e lëvizshmërisë sociale, perceptohen si terren ushqyes për rrjetet kriminale. Mospajtimi minimal (vetëm **2.1%** janë përgjigjur “Aspak”) forcon idenë se varfëria nuk shihet thjesht si një faktor i tërthortë, por si një pikë presioni e drejtpërdrejtë që nxit përfshirjen në krimin e organizuar.


Sa mendoni se ndikon varfëria në përfshirjen e shqiptarëve në krimin e organizuar?



Grafik 31. Opinioni mbi rëndësinë e varfërisë si shkak për përfshirjen në krimin e organizuar

Megjithëse faktorët ekonomikë dominojnë, edhe dinamikat familjare shihen si të rëndësishme. **33.7%** e të anketuarve besojnë se *problemet prindërore* janë një shkak kryesor për përfshirjen e të rinjve në krim, ndërsa **41.1%** i konsiderojnë *disi të rëndësishme*. Ky total prej **74.8%** tregon se neglizhenca emocionale, konfliktet familjare ose mungesa e orientimit, perceptohen si faktorë që nxisin rrugët kriminale, veçanërisht tek grupmoshat e reja. Interesant është fakti se ky faktor shfaq më shumë varietete në opinion, me **18.6%** që e vlerësojnë si *pak të rëndësishëm* dhe **5.0%** që e hedhin plotësisht poshtë. Kjo sugjeron se, ndonëse shumëkush e njeh rolin e familjes, ai shihet si më pak përcaktues sesa vështirësitë ekonomike.

Sa mendoni se ndikojnë marrëdhëniet prindërore e problemet familjare në përfshirjen e shqiptarëve në krimin e organizuar?



Grafik 32. Opinioni mbi rëndësinë e marrëdhënieve prindërore si shkak për përfshirjen e të rinjve në krim

Ndërlidhja e faktorëve socialë

Një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve e shohin si papunësinë, ashtu edhe varfërinë, si shkaqe të rëndësishme për përfshirjen në krimin e organizuar. Kjo pasqyron perceptimin publik se dëshpërimi ekonomik mund t'i shtyjë individët të kërkojnë mundësi në aktivitete të paligjshme.

Ky qëndrim përputhet me kërkimet më të gjera mbi lidhjen midis deprivimit socio-ekonomik dhe krimit. Zonat me nivele të larta papunësie dhe varfërie shpesh përjetojnë nivele më të larta të kriminalitetit, përfshirë edhe krimin e organizuar. Teoritë kriminologjike, si ajo e strukturës së mundësive, sugjerojnë se kur mundësitë legjitime janë të kufizuara, individët kanë më shumë gjasa t'i drejtohen mjeteve joligjore për të arritur sukses ekonomik ose për të përmirësuar kushtet e jetesës.¹ Grupet e krimit të organizuar mund të ofrojnë pikërisht këto mundësi, veçanërisht për popullsitë vulnerabël dhe të marginalizuara.

Faktori	Shumë (%)	Disi (%)	Pak (%)	Aspak (%)	I/e dyzuar (%)
Papunësia	53.7	34.0	10.1	1.9	0.3
Varfëria	58.1	31.2	8.4	2.1	0.2
Problemet/marrëdhëniet prindërore	33.7	41.1	18.6	5.0	1.7

Table 3. Përmbledhja e faktorëve socialë

Faktorët institucional


Të dhënat e marra nga anketa tregojnë një njohje të thellë nga publiku mbi faktorët sistematikë dhe institucionalë që mbajnë gjallë krimin e organizuar. Rezultatet nxjerrin në pah një konsensus të fortë se dënimet e buta, lidhjet politike me krimin, korrupsioni dhe ndikimi i vetë grupeve kriminale janë nxitësit kryesorë të qëndrueshmërisë dhe zgjerimit të krimit të organizuar në vend.

Një përqindje befasuese – **60.5%** e të anketuarve – besojnë se dënimet e buta janë një shkak kryesor i pranisë së krimit të organizuar në Shqipëri, ndërsa **31.7%** të tjerë e konsiderojnë disi të rëndësishëm. Ky konsensus i gjerë prej **92.2%** tregon se publiku e sheh sistemin e drejtësisë si jo mjaftueshëm ndëshkues, duke u lënë aktorëve kriminalë hapësirë për të vepruar me mosndëshkueshmëri. Perceptimi se penaltitetet e lehta nuk arrijnë të pengojnë përsëritjen e veprave penale apo të çmontojnë rrjetet kriminale pasqyron një shqetësim më të gjerë mbi dobësinë institucionale dhe sigurinë gjyqësore. Vetëm **1.3%** e hedhin

¹ Kleemans, Edward R., and Christianne J. De Poot. "Criminal careers in organized crime and social opportunity structure." *European Journal of Criminology* 5.1 (2008): 69-98.

poshtë plotësisht këtë pikëpamje, duke treguar për një pakënaqësi të përgjithshme ndaj regjimit aktual të dënimeve.


Sa të rëndësishme mendoni se janë dënimet e buta ndaj kriminelëve si shkak për praninë e krimit të organizuar në Shqipëri?



Grafik 33. Opinioni mbi rëndësinë e dënimeve të lehta si shkak për praninë e krimit të organizuar

Më shumë se gjysma e qytetarëve shqiptarëve (**51.2%**) besojnë se lidhja midis politikës dhe krimit të organizuar është një faktor kryesor që ndikon në qëndrueshmërinë e tij, ndërsa **36.8%** të tjerë e vlerësojnë si disi të rëndësishëm. Ky total prej **88%** pasqyron ndjenjën e përhapur se aktorët politikë mund të mundësojnë, mbrojnë ose madje të përfitojnë nga rrjetet kriminale. Qoftë përmes financimit të fushatave, ndikimit mbi organet e rendit, apo ndjekjes selektive penale, lidhja e perceptuar mes elitave politike dhe grupeve kriminale duket se ka minuar besimin publik dhe ka forcuar bindjen se krimi i organizuar jo vetëm që tolerohet, por është i rrënjësor në sistem. Vetëm një përqindje e ulët prej **1.9%** e mohojnë këtë lidhje, duke treguar se bashkëpunimi politikë-krim shihet gjerësisht jo si një fenomen rastësor, por si një problem strukturor.

Sa të rëndësishme mendoni se është lidhja midis politikës dhe krimit të organizuar si shkak për praninë e krimit të organizuar në Shqipëri?




Grafik 34. Opinioni mbi rëndësinë e lidhjes midis politikës dhe krimit të organizuar në Shqipëri

Korrupsioni shihet si faktori institucional më i rëndësishëm që nxit krimin e organizuar, me **61.4%** të të anketuarve që e identifikojnë si shkak kryesor dhe

32.6% që e konsiderojnë disi të rëndësishëm. Ky konsensus pothuajse i plotë prej **94%** pasqyron bindjen se praktikatat korruptive – qoftë në forcat e rendit, sistemin gjyqësor apo administratën publike – krijojnë një terren pjellor për veprimtarinë kriminale. Fakti që vetëm **0.5%** e hedhin poshtë korrupsionin si faktor të parëndësishëm nënvizon rolin qendror të tij në diskursin publik. Të dhënat tregojnë se, sipas qytetarëve shqiptarë, krimi i organizuar lulëzon brenda dhe përmes institucioneve të korruptuara.


Sa i rëndësishëm mendoni se është korrupsioni si shkak për praninë e krimit të organizuar në Shqipëri?



Grafik 35. Opinioni mbi rëndësinë e korrupsionit si shkak për praninë e krimit të organizuar në Shqipëri

60.0% e të anketuarve besojnë se veprimtaria e vetë grupeve kriminale është shkak kryesor për përfshirjen e qytetarëve në krimin e organizuar, ndërsa **33.7%** e konsiderojnë disi të rëndësishëm. Kjo tregon se krimi i organizuar shihet jo vetëm si një fenomen nga lart-poshtë, por edhe si një dukuri e ngulitur shoqërisht – ku rrjetet kriminale ushtrojnë presion, ofrojnë përfitime ose normalizojnë sjelljet e paligjshme brenda komuniteteve. Të dhënat tregojnë për një **cikël vetë-përforcues**: sa më shumë që grupet kriminale rriten në fuqi dhe dukshmëri, aq më shumë tërheqin pjesëmarrës të rinj, duke e thelluar dhe forcuar më tej praninë e tyre.

Sa mendoni se ndikon aktiviteti i grupeve kriminale në përfshirjen e shqiptarëve në krimin e organizuar?



Grafik 36. Opinioni mbi rëndësinë e veprimtarive të grupeve kriminale si shkak për përfshirjen në krimin e organizuar

Ndërlidhja e faktorëve institucionalë

Të dhënat nxjerrin në pah një perceptim të fortë publik se faktorët politikë dhe institucionalë janë thellësisht të ndërthurur me qëndrueshmërinë e krimit të organizuar në Shqipëri. Më shumë se gjysma e të anketuarve (**51.2%**) besojnë se lidhja midis politikës dhe krimit të organizuar është një shkak kryesor, ndërsa **36.8%** e konsiderojnë disi të rëndësishëm. Kjo sugjeron se gati **nëntë nga dhjetë shqiptarë** e shohin bashkëpunimin politikë-krim si një çështje strukturore, jo si problem periferik. Implikimi është i qartë: qytetarët dyshojnë se aktorët politikë mund të jenë bashkëfajtorë – qoftë përmes mbrojtjes, lehtësimit apo tolerimit pasiv – në fuqizimin e rrjeteve kriminale.

Edhe më dominues shfaqet korrupsioni, me **61.4%** që e identifikojnë si shkak kryesor dhe **32.6%** si faktor dytësor. Ky konsensus dërrmues prej **94%** pasqyron bindjen se praktikat korruptive brenda institucioneve – veçanërisht në forcat e rendit, gjyqësor dhe administratën publike – krijojnë një terren pjellor për krimin e organizuar. Së bashku, këto shifra përshkruajnë një dobësi sistematike, ku mungesa e llogaridhënies dhe qeverisja e komprometuar shihen si mundësues qendrorë të aktivitetit kriminal. Diagnoza e publikut nuk lidhet thjesht me krimin – ajo është një thirrje për integritet institucional dhe reformë politike.

Faktori	Shumë (%)	Disi (%)	Pak (%)	Aspak (%)	I/e dyzuar (%)
Politika dhe krimi organizuar	51.2	36.8	8.6	1.9	1.5
Korrupsioni	61.4	32.6	5.4	0.5	0.2
Aktiviteti i grupeve kriminale	60.0	33.7	5.3	0.2	0.7

Table 4. Përmbledhje e faktorëve institucional

Aktivitetet e krimit të organizuar depërtojnë thellë në strukturën e shoqërisë dhe lënë pas një sërë pasojash negative në sektorë të ndryshëm. Ky seksion shqyrton ndikimin shumëdimensional të krimit të organizuar, me fokus tek mënyrat se si ai prek grupe të caktuara shoqërore, ekonominë, institucionet demokratike dhe mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve shqiptarë.

Për këtë qëllim, u parashtruan pyetjet:

- Cilat grupe ose individë mendojnë se preken më negativisht nga krimi i organizuar në Shqipëri?
- Cilat grupmosha janë më të prirura për t'u përfshirë në aktivitetet e krimit të organizuar?

- A janë gratë më të prirura apo më pak të prirura për t'u përfshirë në krimin e organizuar?
- A janë gratë më të prirura apo më pak të prirura për t'u bërë viktime të krimit të organizuar?
- Cilat mendoni se janë dëmet më serioze që ka shkaktuar krimi i organizuar në Shqipëri?
- Mendoni se krimi i organizuar ndikon negativisht në mënyrën se si funksionojnë bizneset në Shqipëri?
- Cilat biznese mendoni se preken më negativisht nga krimi i organizuar?

Dobësimi i shoqërisë dhe frenimi i përparimit


Gati gjysma e të anketuarve (**46.9%**) besojnë se individët nga *familjet me të ardhura të ulëta* preken më negativisht nga krimi i organizuar. Ky perceptim mund të pasqyrojë shqetësime mbi zhvatjen, shënjestrimin e bizneseve të vogla ose dëmtimin e stabilitetit ekonomik të shtresave më të brishta. Nga ana tjetër, vetëm **18.6%** i konsiderojnë *familjet me të ardhura të larta* si më të prekura, çka sugjeron se ndërsa varfëria shihet gjerësisht si një nxitës i përfshirjes kriminale, pasuria mund të perceptohet si një faktor që tërheq shfrytëzim nga grupet kriminale. Ndërkohë, një përqindje e konsiderueshme – **33.8%** – thonë se *individët në përgjithësi* preken, duke treguar për një njohje të gjerë mbi shtrirjen gjithëpërfshirëse të krimit të organizuar në shoqëri, pa dallim klase apo statusi ekonomik.



Grafik 37. Opinioni mbi grupet dhe individët më të prekur nga krimi i organizuar në Shqipëri

Grupmosha që lidhet më shumë me përfshirjen në krimin e organizuar është **15–25 vjeç**, e përmendur nga **50.7%** e të anketuarve. Kjo përputhet me shqetësimet më të gjera mbi papunësinë e të rinjve, përjashtimin social dhe joshjen nga “paratë e shpejta”. **36.3%** kanë zgjedhur grupmoshën **26–35 vjeç**, duke forcuar idenë se fillimi i moshës së rritur është periudha më e rrezikshme për rekrutimin kriminal. Shumë pak të anketuar e lidhin krimin e organizuar me moshat më të mëdha (**36–50 vjeç: 8.1%**, **mbi 51 vjeç: 0.7%**), gjë që tregon se ai perceptohet kryesisht si fenomen i drejtuar nga të rinjtë. Megjithatë përqindja për grupmoshën nën **15 vjeç (3.6%)** është e ulët, ajo mbetet shqetësuese, pasi tregon për ekspozim të hershëm dhe vulnerabilitet ndaj krimit të organizuar.

Cilat grup-mosha mendoni se kanë më shumë gjasa të përfshihen në aktivitetet e krimit të organizuar?




Grafik 38. Opinioni mbi grup-moshat më të rrezikuara për t’u përfshirë në krimin e organizuar

Ka një konsensus të gjerë se gratë janë më pak të prirura për t’u përfshirë në krimin e organizuar, me **76.8%** të të anketuarve që mbështesin këtë pikëpamje. Vetëm **6.6%** besojnë se gratë janë më të prirura, ndërsa **16.1%** thonë se ato kanë të njëjtën gjasë si burrat. Kjo tregon se krimi i organizuar perceptohet ende si një fushë e dominuar nga meshkujt, megjithatë një pakicë njihë ekzistencën e barazisë gjinore ose rritjen e përfshirjes së grave.

Megjithatë, kur bëhet fjalë për viktimizimin, tabloja ndryshon. **40.7%** e të anketuarve besojnë se gratë kanë më shumë gjasa të bëhen viktimat e krimit të organizuar, krahasuar me **32.7%** që mendojnë se ato kanë më pak gjasa. Ndërkohë, **25.5%** e shohin nivelin e viktimizimit si të barabartë mes gjinive. Kjo tregon se, ndonëse gratë perceptohen si më pak të përfshira në rrjete kriminale, ato shihen si disproporcionalisht më të cenueshme ndaj pasojave të tij – qoftë përmes trafikimit, shfrytëzimit apo dëmeve indirekte.

Sa mendoni se gratë kanë gjasa të përfshihen në aktivitetet e krimit të organizuar apo të jenë viktima të krimit të organizuar?




Grafik 39. Opinioni mbi rolin e grave në krimin e organizuar: përfshirja dhe viktimizimi

Efektet e krimit të organizuar në shoqëri

Kur u pyetën për dëmet më serioze që shkakton krimi i organizuar, të anketuarit renditën si shqetësim kryesor **dëmtimin e sistemit të drejtësisë penale (21.5%)** dhe **dobësimin e demokracisë dhe legjitimitetit të qeverisjes (19.5%)**. Këto shifra tregojnë për një publik thellësisht të vetëdijshëm për mënyrën se si krimi i organizuar mund të depërtojë dhe dobësojë vetë institucionet që kanë për detyrë të garantojnë drejtësi dhe llogaridhënie demokratike. Pothuajse **19%** përmendën gjithashtu **përhapjen e frikës te popullata**, duke nënvizuar ndikimin psikologjik dhe klimën e intimidimit që mund të ushqejnë rrjetet kriminale.

Interesant është fakti se **23.1%** e të anketuarve besojnë se *të gjitha dëmet e listuara* janë po aq të rëndësishme, duke treguar një kuptim gjithëpërfshirës të kërcënimit shumëdimensional që paraqet krimi i organizuar. Ndërkohë, **dëmi financiar ndaj individëve (6.9%)** dhe **humbjet në buxhetin e shtetit (9.9%)** u perceptuan si më pak serioze – ndoshta duke reflektuar një prioritet më të lartë për integritetin institucional sesa për metrikat ekonomike.

Cilat mendoni se janë dëmet më serioze që ka shkaktuar krimi i organizuar në Shqipëri?




Grafik 40. Opinioni mbi dëmet më serioze të shkaktuara nga krimi i organizuar në Shqipëri

Cenueshmëria e bizneseve dhe deformimi i ekonomisë

Një përqindje befasuese prej **79.4%** e të anketuarve (duke kombinuar përgjigjet “Po” dhe “Anoj nga Po”) – besojnë se krimi i organizuar ndikon negativisht në mënyrën se si operojnë bizneset në Shqipëri. Ky konsensus dërrmues tregon perceptimin se rrjetet kriminale shtrembërojnë dinamikën e tregut, gërryejnë konkurrencën e ndershme dhe krijojnë një mjedis shtrëngues.


A mendoni se krimi i organizuar ndikon negativisht në mënyrën se si funksionojnë bizneset në Shqipëri?



Grafik 41. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në funksionimin e bizneseve në Shqipëri

Kur u pyetën për formatet kryesore të ndikimit, më i përmenduri ishte **evazioni/shmangia fiskale (25.9%)**, çka tregon se krimi i organizuar perceptohet si një aktor që deformon konkurrencën dhe shmang detyrimet ligjore përmes manipulimit të sistemit fiskal. Pas tij vijnë **zhvatja e bizneseve përmes frikësimit (19.4%)** dhe **frikësimi i konkurrentëve (19.0%)**, që ilustrojnë dimensionin e drejtpërdrejtë të dhunës dhe presionit ndaj aktorëve ekonomikë. Një tregues i rëndësishëm është se **31.6%** e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin **“Të gjitha më sipër”**, duke nënkuptuar se shumica e qytetarëve e shohin krimin e organizuar si një fenomen kompleks, me ndikime të shumanshme njëkohësisht – nga kërcënimet fizike, te zhvatja financiare dhe deri te deformimi i rregullave të tregut. Ky perceptim i gjerë nënvizon faktin se krimi i organizuar nuk kufizohet vetëm në veprime të dukshme kriminale, por shtrihet edhe në nivele sistemike që cenojnë integritetin ekonomik dhe sundimin e ligjit.


Cilat mendoni se janë format kryesore të ndikimit mbi ekonominë dhe mënyrën se si funksionojnë bizneset?



Grafik 42. Opinioni mbi format kryesore të ndikimit mbi ekonominë dhe funksionimin e bizneseve

Sa i përket bizneseve më të prekura nga krimi i organizuar, **50.1%** e të anketuarve zgjedhën *bizneset e mëdha*, të ndjekura nga *bizneset e mesme* (**19.7%**) dhe *ato të vogla* (**17.9%**). Ky rezultat sfidon supozimin e zakonshëm se bizneset e vogla janë më të cenueshme, duke sugjeruar se bizneset e mëdha janë më të ekspozuara për shkak të dukshmërisë, pasurive ose rëndësisë së tyre strategjike.

Cilat biznese mendoni se preken më negativisht nga krimi i organizuar?



Grafik 43. Opinioni mbi bizneset më të prekura negativisht nga krimi i organizuar

Dëmi ndaj politikës dhe legjitimiteti i institucioneve

Krimi i organizuar përbën një kërcënim serioz për integritetin e sistemeve politike dhe legjitimitetin e institucioneve, duke minuar proceset demokratike, nxitur korrupsionin dhe duke gërryer besimin publik. Organizatat kriminale depërtojnë në partitë politike përmes financimeve të paligjshme dhe ndikimit, duke manipuluar rezultatet zgjedhore dhe vendimmarrjen politike në funksion të interesave të tyre. Kjo ndërhyrje minon sundimin e ligjit, dobëson mekanizmat e llogaridhënies dhe ushqen një klimë mosndëshkueshmërie, duke gërryer besimin e qytetarëve në drejtësinë dhe efektivitetin e institucioneve shtetërore dhe, në fund, duke destabilizuar qeverisjen demokratike.


Për të marrë opinionet e qytetarëve mbi këtë çështje, u shtruan pyetjet:

- Mendoni se krimi i organizuar në Shqipëri ndikon në punët e brendshme të partive politike?
- Mendoni se krimi i organizuar ndikon në zgjedhjet dhe proceset demokratike në Shqipëri?

- A ndikon krimi i organizuar në vendimmarrjen e qeverisë në nivel qendror?
- A ndikon krimi i organizuar në vendimmarrjen në nivel vendor?
- A ndikon krimi i organizuar në vendimmarrjen e prokurorive të rretheve?
- A ndikon krimi i organizuar në vendimmarrjen e SPAK-ut?
- A ndikon krimi i organizuar në vendimmarrjen e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm?
- A ndikon krimi i organizuar në vendimmarrjen e Gjykatave të Posaçme?
- Mendoni se partitë politike marrin financime nga krimi i organizuar?
- Mendoni se partitë politike i afrohen grupeve kriminale, apo grupet kriminale u afrohen partive politike? (Vetëm për ata që janë përgjigjur “Po” në pyetjen e mëparshme)
- A ndikon krimi i organizuar në raportimin mediatik?
- Cilat mendoni se janë format kryesore të ndikimit të krimit të organizuar në media? (Vetëm për ata që janë përgjigjur “Po” në pyetjen e mëparshme)

Perceptimi se krimi i organizuar ndikon në partitë politike është alarmueshëm i lartë. Një total prej **77.4%** të të anketuarve (duke kombinuar përgjigjet “Po” dhe “Anoj nga Po”) besojnë se **krimi i organizuar ndikon në punët e brendshme të partive**. Kjo pasqyron shqetësimin publik se interesat kriminale mund të formësojnë agjendat politike, përzgjedhjen e kandidatëve apo vendimmarrjen politike – duke minuar përfaqësimin demokratik dhe besimin e qytetarëve.


A mendoni se krimi i organizuar në Shqipëri ndikon në çështjet e brendshme të partive politike?



Grafik 44. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në çështjet e brendshme të partive politike

77.8% e të anketuarve (duke kombinuar përgjigjet “Po” dhe “Anoj nga Po”) besojnë se partitë politike marrin financime nga krimi i organizuar. Ky perceptim tregon se krimi i organizuar nuk ndikon thjesht në politikat publike, por mund të jetë i rrënjosur në vetë ekonominë politike. Një gjetje e tillë ngre pyetje serioze mbi financimin e fushatave, transparencën dhe llogaridhënien në sistemin politik shqiptar.


A mendoni se partitë politike marrin para apo mbështetje në forma të tjera nga krimi i organizuar?



Grafik 45. Opinioni mbi financimin e partive politike nga krimi i organizuar


Mes atyre që pajtohen me këtë pohim, **45.8%** mendojnë se grupet e krimit të organizuar janë ato që nisin kontaktin me partitë politike, ndërsa **29.4%** besojnë të kundërtën – se janë partitë politike ato që i afrohen grupeve kriminale. Kjo tregon një perceptim se aktorët politikë dhe rrjetet kriminale veprojnë me oportunitizëm të ndërsjellë, përmes marrëdhënieve të ndërtuara mbi shkëmbime të favorshme që dëmtojnë llogaridhënien demokratike.

Sipas jush, janë partitë politike ato që i afrohen grupeve të krimit të organizuar, apo janë grupet e krimit të organizuar ato që i afrohen partive politike? (Vetëm për ata që u përgjigjën ‘Po’ në pyetjen e mëparshme)



Grafik 46. Opinioni mbi drejtimin e afrimit midis partive politike dhe grupeve të krimit të organizuar


77.6% e të anketuarve mendojnë se krimi i organizuar ndikon negativisht në zgjedhjet dhe proceset demokratike. Këto shifra pasqyrojnë bindjen e gjerë se rrjetet kriminale mund të ndikojnë në përzgjedhjen e kandidatëve, strategjitë elektorale ose rezultatet zgjedhore, duke minuar kështu legjitimitetin e institucioneve demokratike të Shqipërisë.



Grafik 47. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në zgjedhjet dhe proceset demokratike në Shqipëri

Më shumë se gjysma e të anketuarve (**57.8%** “Po” + “Anoj nga Po”) besojnë se **krimi i organizuar ndikon në vendimarrjen në nivelet më të larta të qeverisjes**. Ky rezultat tregon për perceptimin se politika publike mund të formësohet nga interesa kriminale, qoftë përmes lobimit, shantazhit apo rrjeteve informale. Kjo pasqyron shqetësimin se qeverisja kombëtare nuk është plotësisht e mbrojtur nga ndikimi i paligjshëm.


Qeverisja vendore perceptohet si edhe më e cenueshme sesa institucionet qendrore, me **62.7%** të të anketuarve që shprehen se krimi i organizuar ndikon edhe aty. Kjo mund të lidhet me afërsinë e zyrtarëve vendorë me aktorët kriminalë në nivel komuniteti, ose me dukshmërinë e marrëveshjeve informale në juridiksionet më të vogla. Të dhënat tregojnë se qytetarët e shohin vendimarrjen lokale si një pikë hyrëse kyçe për krimin e organizuar.



Grafik 48. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në vendimarrjen qendrore dhe vendore të qeverisë

Një shumicë e konsiderueshme beson se prokuroritë e rretheve janë të ndikuara nga krimi i organizuar (67.7% “Po” + “Anoj nga Po”). Ky perceptim pasqyron shqetësimet mbi drejtësinë selektive, komprometimin e hetimeve dhe mungesën e pavarësisë në vendimmarrjen e sistemit të prokurorisë. Ai sugjeron se krijimi i SPAK-ut ka qenë i nevojshëm pikërisht sepse strukturat tradicionale shiheshin si të komprometuara. Në kontrast, vetëm **26.2%** (Po + Anoj nga Po) besojnë se SPAK ndikohet nga krimi i organizuar, ndërsa **39.5%** shprehen se e njëjta gjë vlen për Gjykatat e Posaçme. Këto shifra tregojnë se, ndonëse ekziston ende skepticizëm, institucionet e specializuara kundër korrupsionit gëzojnë një besim publik relativisht më të lartë.

A mendoni se krimi i organizuar ndikon në vendimmarrjen e prokurorive të rretheve dhe të SPAK-ut?




Grafik 49. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në vendimmarrjen e prokurorive dhe të SPAK-ut

Gjyqësori jashtë strukturave të specializuara perceptohet si shumë i cenueshëm, me **64.5% të të anketuarve (Po + Anoj nga Po)** që besojnë se ndikohet nga krimi i organizuar. Ky perceptim mund vi si pasojë e skandaleve të së shkuarës, vendimeve të paqëndrueshme ose mungesës së transparencës. Ai sugjeron se reforma në drejtësi mbetet një prioritet publik, ndërsa besimi te sistemi ligjor mbetet i kushtëzuar nga pavarësia e perceptuar.

Gjykatat e Posaçme shihen si më të mbrojtura sesa gjykatat e zakonshme, por gjithsesi përballen me skepticizëm: **39.5% (Po + Anoj nga Po)** besojnë se ato ndikohen. Ndërkohë, **42.5%** anon drejt mendimit se ato nuk ndikohen, por fakti që gati **40%** dyshojnë për ndërhyrje tregon se legjitimiteti institucional ende nuk është fituar. Transparenca e vazhdueshme dhe dënimet e profilit të lartë mund të ndihmojnë në forcimin e besimit publik dhe konsolidimin e rolit të këtyre institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar.


A mendoni se krimi i organizuar ndikon në vendimmarrjen e Gjykatave të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe të Gjykatave të Posaçme?



Grafik 50. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme dhe të posaçme

Edhe media nuk i shpëton perceptimit se ndikohet nga krimi i organizuar. Një total prej **68.3%** të të anketuarve (duke kombinuar “Po” + “Anoj nga Po”) besojnë se **krimi i organizuar ndikon në raportimin mediatik**.

A ndikon krimi i organizuar në raportimet e mediave?



Grafik 51. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në raportimet mediatike

Mes atyre që pajtohen me idenë se media ndikohet nga krimi i organizuar, format më të përmendura të ndikimit janë: korrupsioni ose blerja e pronarëve të mediave (**25.2%**), intimidimi ose ushtrimi i presionit mbi gazetarët (**10.1%**),

blerja drejtpërdrejt e gazetarëve (9.3%), si dhe kombinimi i të gjitha formave të mësipërme (22.6%).

Këto përgjigje pasqyrojnë bindjen se krimi i organizuar formëson narrativat publike duke shtypur raportimet kritike, manipuluar agjendat editoriale dhe bashkëpunuar me platformat mediatike. Rezultati është një peizazh mediatik i kompromentuar, i cili mund të mos arrijë të informojë publikun në mënyrë të paanshme dhe të mbajë pushtetin nën përgjegjësi.

Cilat mendoni se janë format kryesore të ndikimit të krimit të organizuar mbi median? (Vetëm për ata që u përgjigjën 'Po' në pyetjen e mëparshme)



Grafik 52. Opinioni mbi format kryesore të ndikimit të krimit të organizuar mbi median

	Po (%)	Anoj nga Po (%)	Po + Anoj nga Po (%)
Partitë politike	35.3	42.1	77.4
Zgjedhjet dhe proceset demokratike	32.9	37.3	70.2
Vendimarrja e qeverisjes qendrore	24.9	32.9	57.8

Vendimarrja e qeverisjes lokale	30.4	32.3	62.7
Prokurorite e rretheve	29.2	38.5	67.7
SPAK	8.0	18.2	26.2
Gjykatat e rretheve	25.7	38.8	64.5
Gjykatat e Posaçme	13.0	26.5	39.5

Table 5. Përqindja e kombinuar e ndikimit të krimit të organizuar

Të dhënat paraqesin një pamje shqetësuese mbi mënyrën se si shqiptarët e perceptojnë shtrirjen dhe ndikimin e krimit të organizuar në jetën e qytetarëve, institucionet demokratike, peizazhin ekonomik dhe mjedisin mediatik. Këto gjetje pasqyrojnë një publik që jo vetëm është i vetëdijshëm për praninë e krimit të organizuar, por është thellësisht i shqetësuar për rrënjosjen e tij në strukturën institucionale të Shqipërisë.

Krimi i organizuar dhe zgjedhjet e 11 Majit 2025

Integriteti i proceseve zgjedhore është themelor për funksionimin e një demokracie. Ky seksion shqyrton perceptimet e qytetarëve shqiptarë mbi ndikimin e krimit të organizuar në zgjedhjet e 11 majit 2025, ashtu siç pasqyrohen nga të dhënat e anketës. Vëmendja përqendrohet tek pyetjet nëse krimi i organizuar ndikoi në fushatë, në rezultatin zgjedhor, në mekanizmat specifikë të ndikimit dhe cilat qarqe u perceptuan si më të prekura.


Për këtë qëllim, u parashtruan pyetjet:

- *Mendoni se krimi i organizuar ka ndikuar partitë politike gjatë fushatës zgjedhore të 11 majit?*
- *Mendoni se krimi i organizuar ka ndikuar rezultatin e zgjedhjeve të 11 majit 2025?*
- *Si mendoni se krimi i organizuar ka ndikuar zgjedhjet? (Vetëm ata që u përgjigjën “Po” ose “Anoj nga Po”)*
- *Mendoni se krimi i organizuar ka ndikuar posaçërisht në zgjedhjet e qarkut tuaj? (Vetëm ata që u përgjigjën “Po” ose “Anoj nga Po”)*
- *Cilat qarqe/prefektura mendoni se u prekën më shumë? (Vetëm ata që u përgjigjën “Po” ose “Anoj nga Po”)*

- *Ku i morët informacionet për ndikimin e krimit të organizuar tek partitë politike dhe zgjedhjet?*
- *A njihni ndonjë të afërm, familjar ose mik që është kontaktuar nga dikush i lidhur me aktivitete kriminale për të ndikuar se për cilën parti apo kandidat të votonte ose të mos votonte?*
- *A njihni ndonjë mik apo të afërm që ka votuar për një parti apo kandidat në këmbim të parave ose të favoreve të premtuara?*

Një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve – **62.9%** (“Po”: 30.4%, “Anoj nga Po”: 32.5%) – besojnë se krimi i organizuar ka ndikuar partitë politike gjatë fushatës zgjedhore. Vetëm **8.6%** e hodhën poshtë kategorikisht këtë ide, ndërsa **25.8%** anuan drejt skepticizmit, duke treguar një perceptim publik të nuancuar, por kryesisht kritik ndaj integritetit të fushatës.

A mendoni se krimi i organizuar ka ndikuar tek partitë politike gjatë fushatës zgjedhore të 11 majit?




Grafik 53. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në partitë politike gjatë fushatës zgjedhore të 11 majit

Kur u pyetën nëse krimi i organizuar ndikoi në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, **55.4%** e të anketuarve u përgjigjën pozitivisht (“Po”: 24.8%, “Anoj nga Po”: 30.6%). Kjo pasqyron një besim disi më të ulët – por ende shumicë – se ndërhyrja kriminale shkoi përtej fushatës, duke përfshirë manipulimin e votave ose shtrembërimin e rezultateve. Nga ana tjetër, një total prej **41.6%** (“Anoj nga Jo”: 27.0%, “Jo”: 14.6%) shprehën dyshim, duke treguar se, ndonëse shqetësimet janë të përhapura, ato nuk janë të përgjithshme.

Hendeku mes perceptimit të ndikimit mbi fushatën (**62.9%** Po + Anoj nga Po) dhe atij në rezultat (**55.4%** Po + Anoj nga Po) tregon se, ndonëse shumëkush beson se krimi i organizuar ndikoi në sjelljen e partive politike dhe në dinamikën e fushatës, një numër disi më i vogël mendon se ai ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatet përfundimtare – duke treguar një perceptim të shtresëzuar të ndikimit.


A mendoni se krimi i organizuar ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve të 11 Majit?



Grafik 54. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në rezultatin e zgjedhjeve të 11 majit

Mes të anketuarve që u përgjigjën “Po” ose “Anoj nga Po” për ndikimin e krimit të organizuar, **21.2%** besojnë se janë përdorur të gjitha mekanizmat – blerja e votës, financimi i partive politike dhe frikësimi i votuesve. **18.2%** përmendën **blerjen e votës** si metodën kryesore, duke nënvizuar shqetësimet për manipulimin e drejtpërdrejtë të sjelljes së votuesve. **12.4%** përmendën **financimin e partive**, duke treguar dyshime se fondet e paligjshme kanë ndikuar në formësimin e agjendave politike. **3.5%** përmendën **frikësimin e votuesve**, një shqetësim më i vogël në shifra, por megjithatë domethënës. Kjo ndarje tregon se, mes atyre që shprehin shqetësim, shumë e shohin rolin e krimit të organizuar si një fenomen sistemik dhe shumëdimensional.


Sipas jush, në ç'mënyrë ka ndikuar krimi i organizuar në zgjedhje? (Vetëm për ata që u përgjigjën 'Po' ose 'Anoj nga Po')



Grafik 55. Opinioni mbi mënyrat e ndikimit të krimit të organizuar në zgjedhje

Mes atyre që besojnë se krimi i organizuar ndikoi në zgjedhje, **47.3%** ("Po": 21.3%, "Anoj nga Po": 26.0%) mendojnë se edhe qarku i tyre ka qenë i prekur. Vetëm **6.3%** ("Anoj nga Jo": 4.8%, "Jo": 1.5%) nuk ranë dakord, ndërsa **1.8%** shprehën pasiguri. Këto të dhëna tregojnë se perceptimet për ndikimin e krimit të organizuar nuk janë thjesht abstrakte, të formësuara nga narrativat në nivel kombëtar, por përjetohen edhe në nivel lokal.


A mendoni se ka ndikuar konkretisht në qarkun tuaj krimi i organizuar në zgjedhje? (Vetëm për ata që u përgjigjën 'Po' ose 'Anoj nga Po')



Grafik 56. Opinioni mbi ndikimin e krimit të organizuar në zgjedhjet e qarkut të banimit

Elbasani, Tirana, Fieri dhe Shkodra dallohen si zona të ndjeshme ndaj ndikimit, ndoshta për shkak të garës së fortë politike, rëndësisë së tyre ekonomike ose episodëve të mëparshme të parregullsive zgjedhore. Këto gjetje paraqesin një tablo të shqetësimit të thellë publik mbi integritetin e proceseve zgjedhore në Shqipëri.


Me sa keni dijeni, cilat janë qarqet ku krimi i organizuar ka ndikuar më shumë në procesin zgjedhor? (Vetëm për ata që u përgjigjën 'Po' ose 'Anoj nga Po')



Grafik 57. Opinioni mbi qarqet më të prekura nga krimi i organizuar në zgjedhje

Të dhënat tregojnë se mediat tradicionale mbeten burimi dominues i informacionit për shqiptarët lidhur me ndikimin e krimit të organizuar tek partitë politike dhe zgjedhjet. Më shumë se gjysma e të anketuarve (**55.4%**) përmendën televizionin, radion dhe gazetat si burimin e tyre kryesor, duke theksuar autoritetin e vazhdueshëm të mediave klasike në formësimin e kuptimit publik mbi dinamikat politiko-kriminale. Ndërkohë, **22.6%** e të anketuarve mbështeten tek rrjetet sociale dhe portalet online, çka pasqyron rritjen e ndikimit të


platformave digjitale në shpërndarjen e informacionit politik – megjithëse shpesh me nivele të ndryshme besueshmërie. Një segment më i vogël (**15.2%**) raportoi se i mëson këto çështje përmes thashethemeve, miqve ose të afërmeve, duke treguar se rrjetet informale gjithashtu kontribuojnë në formësimin e perceptimeve, sidomos në komunitetet e lidhura ngushtë. Vlen të theksohet se vetëm **6.0%** pohuan se nuk kishin informacion mbi këtë temë dhe vetëm **0.8%** u shprehën të pasigurt, duke treguar se ndërgjegjësimi mbi ndikimin politik të krimit të organizuar është i përhapur dhe diskutohet gjerësisht në kanale të ndryshme. Kjo shpërndarje nënvizon rëndësinë e edukimit mediatik dhe nevojën për një raportim transparent dhe të bazuar në fakte, për të kundërshtuar dezinformimin dhe për të thelluar të kuptuarit publik. Po ashtu, tregon se gazetaria investigative dhe raportimi i mediave tradicionale luajnë një rol kritik në informimin e qytetarëve mbi integritetin zgjedhor dhe cënueshmëritë institucionale.



Grafik 58. Opinioni mbi burimet e informacionit mbi ndikimin e krimit të organizuar në partitë politike dhe zgjedhje

Megjithatë, përtej formësimit të opinionit përmes kanaleve mediatike, kur vëmendja zhvendoset tek përvoja personale brenda rrethesh shoqërore, **20.9%** e të anketuarve thanë se njohin një mik ose të afërm që është kontaktuar nga dikush potencialisht i lidhur me rrjete kriminale, me synimin për të ndikuar votën e tyre. Këto rezultate tregojnë një ndikim të përhapur, që vepron përmes besimit në marrëdhënie dhe presionit joformal.


A dini për ndonjë mik apo të afërm që është kontaktuar nga ndonjë person ndoshta me lidhje apo përfshirje në aktivitete kriminale, për të ndikuar se cilës parti apo kandidati t'ia jepte apo mos t'ia jepte votën?



Grafik 59. Opinioni mbi rastet e kontaktit nga krimi i organizuar për të ndikuar votën

Shifra më domethënëse delin në pah kur shqyrtohet sjellja transaksionale e votimit. **25.6%** e të anketuarve pranuan se njohin dikë që ka votuar për një parti ose kandidat në këmbim të parave ose favoreve të premtuara. Kjo tregon se ndryshimi i votës mbetet një fenomen i dukshëm dhe i pranuar shoqërisht. Megjithatë, **72.0%** mohuan të njihnin dikë të përfshirë në këto shkëmbime, ndërsa **2.5%** refuzuan të përgjigjeshin – duke nënvizuar edhe njëherë ndjeshmërinë e lartë të kësaj teme.

A dini për ndonjë mik apo të afërm që e ka dhënë votën për një parti apo kandidat, në shkëmbim të parave apo të favoreve të premtuara?



Grafik 60. Opinioni mbi rastet e votimit në këmbim të parave ose favoreve

Të marra së bashku, këto gjetje tregojnë se ndikimi kriminal mbi zgjedhjet në Shqipëri nuk është thjesht çështje e incidenteve të izoluar, por një fenomen i rrënjësor në shoqëri. Për të mbrojtur integritetin e zgjedhjeve të ardhshme dhe për të forcuar qeverisjen demokratike, Shqipëria ka nevojë për veprime të gjithanshme dhe vendimtare, dhe jo vetëm për një qasje të thjeshtë të zbatimit ligjor.

Efektiviteti i performancës institucionale në parandalimin e ndikimit të krimit të organizuar mbi procesin dhe rezultatin zgjedhor

Duke qenë se është pranuar ekzistenca e problemit të ndikimit të padrejtë mbi votën, u zbatua një qasje shumë-institucionale që përfshiu një sërë institucionesh për të parandaluar dhe hetuar krimin zgjedhor. Për të marrë opinionin e qytetarëve mbi performancën e këtyre institucioneve në këtë drejtim, u shtruan pyetjet:

- *Mendoni se Policia e Shtetit e ka përmbushur në mënyrë efektive detyrën e saj për të parandaluar krimin e organizuar nga ndikimi mbi zgjedhjet?*
- *Mendoni se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka përmbushur në mënyrë efektive detyrën e tij për të parandaluar krimin e organizuar nga ndikimi mbi zgjedhjet?*
- *Mendoni se SPAK e ka përmbushur në mënyrë efektive detyrën e tij për të parandaluar krimin e organizuar nga ndikimi mbi zgjedhjet?*
- *Mendoni se Prokuroria e Përgjithshme e kanë përmbushur në mënyrë efektive detyrën e tyre për të parandaluar krimin e organizuar nga ndikimi mbi zgjedhjet?*
- *Mendoni se Partitë Politike kanë bërë përpjekje të mjaftueshme për të parandaluar krimin e organizuar nga ndikimi mbi zgjedhjet?*

Perceptimet e publikut mbi përpjekjet institucionale për të parandaluar ndikimin e krimit të organizuar në zgjedhjet e 11 majit 2025 zbulojnë një përzierje komplekse aprovimi të kujdesshëm, skepticizmi dhe mosbesimi të thellë, veçanërisht ndaj aktorëve politikë. Ndërsa disa organe shtetërore shihen si të angazhuara në mënyrë të besueshme, të tjera perceptohen si të mangëta, dhe partitë politike konsiderohen gjerësisht si joaktive ose bashkëfajtores.


Policia e Shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) gëzuan nivele mesatare besimi publik. Për Policinë e Shtetit, vetëm **13.2%** e të anketuarve thanë se e kishte përmbushur plotësisht rolin e saj, ndërsa **39.9%** anuan drejt konfirmimit. Megjithatë, një total prej **45.3%** (Anoj nga Jo + Jo) shprehën dyshim ose mos konfirmim të qartë, duke treguar se përpjekjet zbatuese janë parë si të paqëndrueshme ose të pamjaftueshme.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pati një performancë të ngjashme: **15.2%** e të anketuarve shprehën besim të plotë, **39.5%** shprehën prirje pozitive, ndërsa **43.2%** u treguan skeptikë. Këto shifra pasqyrojnë një opinion publik të ndarë, pothuajse në mënyrë të barabartë mes atyre që shprehin besim dhe atyre që kanë shqetësime—ndoshta të ndikuara nga ndryshimet lokale në zbatim, dukshmëria e ndërhyrjeve apo edhe nga polemika të mëparshme.

Në kontrast, SPAK spikat si institucioni më i besuar në këtë kontekst. Një total prej **70.5%** të të anketuarve (Po + Anoj nga Po) besojnë se SPAK e ka përmbushur në mënyrë efektive rolin e tij në parandalimin e ndikimit zgjedhor të krimit të organizuar. Vetëm **27.7%** shprehën dyshim ose mosaprovim. Kjo tregon se reputacioni i SPAK-ut për pavarësi dhe ndjekjet penale të profilit të lartë është përkthyer në besim më të madh publik, duke e pozicionuar atë si një gur themeli të integritetit institucional në luftën kundër ndërhyrjes kriminale.

Ndërkohë, Prokuroria e Përgjithshme nuk gëzon të njëjtin nivel besimi. Vetëm **13.3%** e të anketuarve deklaruan se ky institucion i ka përmbushur plotësisht përgjegjësitë e saj, ndërsa **37.4%** shprehën prirje pozitive. Megjithatë, **45%** shprehën skepticizëm ose mosaprovim, dhe **4.4%** shprehën pasiguri – duke treguar se Prokuroria e Përgjithshme perceptohet si më të cënueshme ndaj ndikimit ose më pak efektive se SPAK.


A mendoni se Policia e Shtetit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, SPAK dhe Prokuroria e Përgjithshme e kanë kryer detyrën me efikasitet për të parandaluar ndikimin e krimit të organizuar në zgjedhje?



Grafik 61. Opinioni mbi efikasitetin e institucioneve në parandalimin e ndikimit të krimit të organizuar në zgjedhje

Megjithatë, qytetarët shprehen shumë më pak të sigurt për përpjekjet e partive politike në këtë drejtim. Vetëm **5.7%** e të anketuarve besojnë se partitë kanë bërë përpjekje të mjaftueshme për të parandaluar ndërhyrjen e krimit të organizuar në zgjedhje, dhe vetëm **26.1%** anuan pozitivisht. Në kontrast të fortë, **63.2%** (Anoj nga Jo + Jo) shprehën pakënaqësi të qartë. Kjo mungesë dërmues besimi tregon se partitë politike shihen gjerësisht si pasive, bashkëfajtores ose joefektive në përballjen me ndikimin kriminal – duke thelluar edhe më shumë shqetësimet mbi lidhjet dhe ndërthurjen mes politikës dhe krimit të organizuar.

A mendoni se Partitë Politike kanë bërë përpjekje për të parandaluar ndikimin e krimit të organizuar në zgjedhje?



Grafik 62. Opinioni mbi përpjekjet e partive politike për të parandaluar ndikimin e krimit të organizuar në zgjedhje

Trendet, ndryshimet dhe pritshmëritë

Ky seksion shqyrton performancën e përgjithshme të institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar dhe pritshmëritë për të ardhmen. Për këtë qëllim, u parashtruan pyetjet:


- Gjatë tre viteve të fundit, prania e krimit të organizuar në Shqipëri ka qenë:
- Mendoni se ligji për dekriminalizimin ka dhënë rezultate në mbajtjen e krimit të organizuar larg institucioneve të zgjedhura nga votuesit?
- Mendoni se ligji për dekriminalizimin ka dhënë rezultate në mbajtjen e krimit të organizuar larg administratës publike?

- *Mendoni se ligji për dekriminalizimin ka dhënë rezultate në reduktimin e ndikimit të krimit të organizuar mbi institucionet e qeverisjes qendrore?*
- *Mendoni se ligji për dekriminalizimin ka dhënë rezultate në reduktimin e ndikimit të krimit të organizuar mbi qeverisjen vendore?*
- *Mendoni se ndikimi i krimit të organizuar mbi POLITIKËN do të reduktohet në katër vitet e ardhshme?*
- *Mendoni se ndikimi i krimit të organizuar mbi EKONOMINË do të reduktohet në katër vitet e ardhshme?*
- *Gjatë tre viteve të fundit, performanca e përgjithshme e institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar ka qenë:*
- *Sa besoni se procesi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka përmirësuar luftën kundër krimit të organizuar?*
- *Mendoni se sistemi i drejtësisë do të jetë efektiv për të frenuar krimin e organizuar në katër vitet e ardhshme?*

Perceptimi publik mbi krimin e organizuar në Shqipëri gjatë tre viteve të fundit pasqyron një ndjesi mbizotëruese shqetësimi dhe stanjacioni, me një shumicë relative të të anketuarve – **42.2%** – që besojnë se prania e tij është *rritur*. Kjo tregon se, pavarësisht reformave institucionale dhe përpjekjeve të bujshme të zbatimit të ligjit, shumë qytetarë ndjejnë se rrjetet kriminale janë bërë më të dukshme, më me ndikim ose më prezente në shoqëri. Ky perceptim për rritje ushqehet nga mbulimi mediatik, skandalet politike dhe përjetimet e përditshme të qytetarëve, të cilat forcojnë bindjen se krimi i organizuar vazhdon të përshtatet dhe të zgjerohet.

Në të njëjtën kohë, **26.9%** e të anketuarve besojnë se situata ka *mbetur e pandryshuar*, duke treguar një ndjenjë ngecjeje ose mungesë progresi të dukshëm. Ky grup nuk e percepton situatën si të përkeqësuar, por as nuk sheh përmirësim—duke reflektuar një zhgënjim më të gjerë me status quo-në. Në kontrast, **29.9%** besojnë se krimi i organizuar është *ulur*, duke pasqyruar mendimin e një pakice se përpjekjet e fundit – si p.sh. ndjekjet penale të SPAK-ut ose rritja e vëmendjes publike – kanë sjellë një ndikim të prekshëm. Shkalla e ulët e pasigurisë (**1.1%**) tregon se shumica e shqiptarëve ndihen të sigurt në vlerësimet e tyre, qofshin ato optimiste apo kritike.

Gjatë tre viteve të fundit, prania e krimit të organizuar në Shqipëri është:



Grafik 63. Opinioni mbi praninë e krimit të organizuar në Shqipëri gjatë tre viteve të fundit

Në dhjetor 2015, Shqipëria miratoi Ligjin për Dekriminalizimin, me synimin që individët në funksione publike të respektojnë standarde të larta integriteti dhe të jenë të lirë nga ndikimi apo përfshirja kriminale. Deri më tani, ky ligj ka shpënë në shkarkimin ose dorëheqjen e një numri zyrtarësh, përfshirë deputetë, kryetarë bashkish dhe këshilltarë vendorë. Ligji synon kryesisht të parandalojë emërimin në detyrë të personave me precedentë penalë.

Të dhënat zbulojnë një perceptim publik të nuancuar dhe disi të dyzuar mbi ndikimin e Ligjit të 2015-s për Dekriminalizimin, veçanërisht sa i takon efektivitetit të tij në kufizimin e ndikimit të krimit të organizuar në nivele të ndryshme të qeverisjes.


Kur u pyetën nëse ligji ka ndihmuar për të larguar krimin e organizuar nga institucionet e zgjedhura me votë, vetëm **10.4%** e të anketuarve dhanë një përgjigje të prerë “Po”, ndërsa një pjesë më e madhe (**37.8%**) shprehën prirje pozitive. Të marrë së bashku, këto shifra tregojnë se gati gjysma e qytetarëve (**48.2%**) e shohin ligjin si disi të suksesshëm. Megjithatë, skepticizmi mbetet i fortë: **29.7%** shprehën prirje negative dhe **18.9%** u shprehën “Jo”, duke treguar se pothuajse **gjysma e qytetarëve** dyshon mbi efektivitetin e ligjit në mbrojtjen e integritetit zgjedhor. Vetëm **3.3%** ishin të pasigurt – një përqindje shumë e ulët që tregon se shumica e qytetarëve shqiptarë kanë një mendim të qartë.

Perceptimet mbi ndikimin e ligjit në administratën publike ndjekin një model të ngjashëm. Vetëm **9.9%** u përgjigjën me një “Po” të prerë, ndërsa **37.4%** anonin drejt një qëndrimi pozitiv. Por **32.7%** anuan negativisht dhe **17.1%** u shprehën “Jo”, duke treguar se **49.8%** e të anketuarve shprehën dyshim ose shqetësim mbi aftësinë e ligjit për ta izoluar administratën publike nga ndikimi kriminal.

Përsëri, niveli i pasigurisë (**3.0%**) mbetet i ulët, ç'ka tregon sërish se çështja është e kuptuar mirë dhe diskutohet gjerësisht.

Sa i përket institucioneve të qeverisjes qendrore, opinioni publik mbetet i ndarë. Vetëm **9.5%** u përgjigjën me një "Po" të qartë dhe **37.8%** shprehën prirje pozitive – pra gjithsej **47.3%** me shfaqin një nivel besimi në ndikimin e ligjit. Nga ana tjetër **32.9%** u shprehën kryesisht negativë dhe **17.3%** dhanë një "Jo" të prerë, që do të thotë se **50.2%** e të anketuarve mbeten skeptikë. Vetëm **2.6%** ishin të pasigurt, përqindja më e ulët nga të gjitha kategoritë, duke treguar një angazhim të fortë publik mbi këtë çështje.

A mendoni se ligji për dekriminalizimin/pastrimin e figurës së zyrtarëve ka dhënë rezultate në mbajtjen e krimit të organizuar larg.....?




Grafik 64. Opinioni mbi ndikimin e ligjit për dekriminalizimin në mbajtjen e krimit të organizuar larg institucioneve

Kur u pyetën nëse kapja e politikës nga krimi i organizuar do të bjerë, **14.1%** e të anketuarve shprehën optimizëm të qartë, ndërsa një grup dukshëm më i madh – **40.6%** – *anuan pozitivisht*. Pra, në total **54.7%** tregojnë se më shumë se gjysma e qytetarëve sheh njëfarë mundësie për përparim, gjë që ndoshta lidhet me besimin tek reformat në vazhdim, forcimin institucional apo presionin publik për llogaridhënie.

Megjithatë, ky optimizëm mbetet i brishtë. Një total prej **42.4%** e të anketuarve u shprehën kryesisht negativë (**26.1%**) ose dhanë një "Jo" të prerë (**16.3%**), duke treguar se gati gjysma e qytetarëve mbetet e pavendosur nëse ndryshimi i vërtetë është afër. Shkalla e ulët e pasigurisë (**2.9%**) tregon se kjo çështje është thellësisht e rrënjësuar dhe shumë e pranishme në debatin publik.

A mendoni se ndikimi i krimit të organizuar në POLITIKË do të ulët në 4 vitet e ardhshme?




Grafik 65. Opinioni mbi ndryshimin e ndikimit të krimit të organizuar në politikë në 4 vitet e ardhshme

Perceptimet mbi ndikimin e krimit të organizuar në ekonomi janë disi më pesimiste. Vetëm **10.4%** e të anketuarve besojnë se ndikimi i tij do të reduktohet ndjeshëm, dhe **38.2%** anuan pozitivisht – një total prej **48.6%**, dukshëm më i ulët se në fushën politike. Ndërkohë, **29.1%** anuan negativisht dhe **19.9%** u shprehën “Jo”, duke arritur një total prej **49%** që dyshojnë se strukturat ekonomike do të mund të izolojnë në mënyrë domethënëse nga ndikimi kriminal në të ardhmen e afërt.

Ky ndarje pothuajse e barabartë sugjeron se, ndërsa disa të anketuar shohin potencial në reformat fiskale, përpjekjet kundër pastrimit të parave ose presionin ndërkombëtar, të tjerë mbeten skeptikë – ndoshta për shkak të perceptimit se rrjetet e paligjshme janë të ngulitura thellë në sektorë kyç si ndërtimi, energjia apo prokurimet publike. Shkalla e ulët e pasigurisë (**2.4%**) përsëri reflekton një ndërgjegjësim dhe angazhim të lartë publik.


A mendoni se ndikimi i krimit të organizuar në EKONOMI/BIZNES do të ulët në 4 vitet e ardhshme?



Grafik 66. Opinioni mbi ndryshimin e ndikimit të krimit të organizuar në ekonomi dhe biznese në 4 vitet e ardhshme”

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve prej **40.0%** besojnë se përpjekjet institucionale janë *përmirësuar*, duke sugjeruar se reformat, ndjekjet penale dhe rritja e dukshmërisë së nismave kundër krimit – si aktivitetet e SPAK-ut ose bashkëpunimi ndërkombëtar – kanë filluar të përputhen me një pjesë të konsiderueshme të qytetarëve. Ky grup, me gjasë, sheh shenja progresi, qoftë përmes raportimeve mediatike, diskursit politik ose rezultateve të prekshme si arrestime dhe sekuestre pasurish. Megjithatë, pjesa më e madhe – **47.0%** – percepton *mungesë ndryshimi*, duke treguar se pothuajse gjysma e shqiptarëve ndjejnë se lufta kundër krimit të organizuar ka ngecur. Ky qëndrim mund të pasqyrojë frustrimin me ritmin e reformës, perceptimin e pandëshkueshmërisë ose elasticitetin e rrjeteve kriminale brenda strukturave politike dhe ekonomike. Kjo tregon se, ndonëse ka progres të dukshëm, ai ende nuk është përkthyer në një transformim sistematik ose në besim të gjerë publik. Vetëm **12.3%** besojnë se situata është *përkeqësuar* – një pikëpamje e pakicës, por gjithsesi e rëndësishme, që sinjalizon shqetësime se krimi i organizuar mund të përshtatet më shpejt se sa arrijnë institucionet të përgjigjen, ose se përpjekjet zbatuese janë të pabarabarta ose të politizuara. Shkalla shumë e ulët e pasigurisë (**0.8%**) nënvizon se kjo çështje përcillet nga afër dhe se qytetarët kanë qëndrime të konsoliduara mbi të.

Gjatë tre viteve të fundit, puna e përgjithshme e institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar është:




Grafik 67. Opinioni mbi punën e institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar gjatë tre viteve të fundit

Procesi i vetingut është konsideruar si kyç për pastrimin e korrupsionit në gjyqësor dhe, rrjedhimisht, për përmirësimin e performancës së tij në luftën kundër krimit të organizuar. Një total prej **60.7%** të të anketuarve shprehin *njëfarë* niveli besimi ndaj këtij procesi: **17.4%** deklaruan se i *besojnë shumë*, ndërsa **43.3%** shprehën një qëndrim më të rezervuar, duke shprehur besim të *pjesëshëm*.

Kjo shumicë tregon se publiku e sheh vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve si një mekanizëm potencialisht efektiv për të pastruar gjyqësorin nga aktorët e komprometuar dhe për të forcuar integritetin institucional. Megjithatë, **38.3%** e të anketuarve mbeten dyshues: **25.6%** shprehin *pak besim*, dhe **12.7%** thonë se *nuk i besojnë aspak*. Skepticizmi i tyre mund të burojnë nga perceptimi i politizimit, mungesa e rezultateve të dukshme ose shqetësimi se procesi shënjestron individë në mënyrë selektive dhe jo në mënyrë sistematike. Të dhënat theksojnë si legjitimitetin, ashtu edhe brishtësinë e besimit publik në reformën institucionale.


Sa besoni se procesi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve
e ka përmirësuar luftën kundër krimit të organizuar?



Grafik 68. Opinioni mbi ndikimin e procesit të vetingut në luftën kundër krimit të organizuar

Publiku shqiptar shpreh një **optimizëm të matur** mbi potencialin e sistemit të drejtësisë për të frenuar krimin e organizuar gjatë katër viteve të ardhshme, megjithëse ky perceptim shoqërohet me skepticizëm të vazhdueshëm dhe një kërkesë të fortë për më shumë besueshmëri institucionale. Një total prej **62.6%** të të anketuarve – **16.4%** që u përgjigjën “Po” dhe **46.2%** që anuan pozitivisht – besojnë se sistemi i drejtësisë mund të jetë efektiv në përballjen me krimin e organizuar. Kjo shumicë tregon për një nivel domethënës besimi publik, ndoshta i ndikuar nga reformat gjyqësore të viteve të fundit, puna e SPAK-ut dhe ndjekjet penale të profilit të lartë që kanë filluar të sfidojnë pandëshkueshmërinë. Megjithatë, ky optimizëm nuk është i pakushtëzuar. **33.7%** e të anketuarve – **21.9%** që anuan negativisht dhe **11.8%** që u përgjigjën “Jo” – mbeten dyshues. Skepticizmi i tyre mund të lidhet me ndikimin politik, zbatimin e pabarabartë ose ritmin e ngadaltë të ndryshimeve strukturore. Ndërkohë, **3.8%** e të anketuarve që janë të *pasigurt* tregon se, ndonëse shumica e shqiptarëve kanë formuar tashmë një opinion, ekziston një segment i vogël që mbetet i pasigurtë.

A mendoni se sistemi i drejtësisë do të jetë efektiv për të frenuar krimin e organizuar në 4 vitet e ardhme?



Grafik 69. Opinioni mbi efektivitetin e sistemit të drejtësisë në frenimin e krimit të organizuar në 4 vitet e ardhshme

Performanca insitucionale dhe besimi

Ky seksion përqendrohet në aspektet kritike të luftës kundër krimit të organizuar në Shqipëri: mënyrën se si perceptohen përpjekjet aktuale institucionale, nivelin e besimit publik tek institucionet e ngarkuara me këtë mision dhe nivelin e pavarësisë politike të perceptuar. U shtruan gjithashtu pyetje mbi mbështetjen ndërkombëtare në këtë fushë.

Pyetjet e parashtruara ishin:

- Mendoni se Qeveria është serioze në luftën kundër krimit të organizuar?
- Mendoni se Gjykatat e Posaçme janë serioze në luftën kundër krimit të organizuar?
- Mendoni se SPAK është serioz në luftën kundër krimit të organizuar?
- Mendoni se vendimmarrja e SPAK-ut ndikohet nga politika?
- Mendoni se vendimmarrja e Gjykatave të Posaçme ndikohet nga politika?
- Si do ta vlerësonit kontributin e SPAK-ut në luftën kundër krimit të organizuar?
- Si do ta vlerësonit kontributin e Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar?


- *A besoni se nëse raportoni një vepër penale të lidhur me krimin e organizuar, ajo do të ndiqet siç duhet nga Policia e Shtetit?*
- *A besoni se nëse raportoni një vepër penale të lidhur me krimin e organizuar, ajo do të ndiqet siç duhet nga SPAK?*
- *Mendoni se administrata publike mund të luajë një rol në luftën kundër krimit të organizuar?*
- *Si i gjykoni dënimet e dhëna nga gjykatat për individët e përfshirë në krimin e organizuar?*
- *Si do ta vlerësonit kontributin e BE-së në luftën kundër krimit të organizuar?*
- *Si do ta vlerësonit kontributin e SHBA-së në luftën kundër krimit të organizuar?*

Kur u pyetën nëse qeveria është serioze në luftën kundër krimit të organizuar, vetëm **14.7%** e të anketuarve shprehën besim të plotë, ndërsa **37.0%** anonin drejt një vlerësimi pozitiv. Megjithatë, një total prej **46.5%** (Anoj nga Jo: 28.4%, Jo: 18.1%) shprehën skepticizëm ose dyshim të hapur. Kjo tregon se, ndonëse disa qytetarë njohin përpjekjet e qeverisë, pothuajse gjysma mbeten të pakënaqur – ndoshta për shkak të ndërthurjes politike, zbatimit të pabarabartë ose mungesës së transparencës. Shkalla e ulët e pasigurisë (**1.8%**) tregon se shumica e shqiptarëve kanë një opinion të qartë mbi këtë çështje.

Në kontrast, Gjykatat e Posaçme gëzojnë një reputacion më të lartë. Një total prej **65.8%** të të anketuarve (Po: 17.3%, Anoj nga Po: 48.5%) besojnë se këto gjykata janë serioze në misionin e tyre për të luftuar krimin e organizuar. Vetëm **30.7%** shprehën dyshim dhe **3.6%** shprehën pasiguri. Kjo pasqyron një rritje të besimit publik tek organet e posaçme të sistemit gjyqësor dhe tek roli i institucioneve të dedikuara kundër korrupsionit në ofrimin e një drejtësie të paanshme.

SPAK del qartë si institucioni më i besuar në këtë fushë. **80%** e të anketuarve (Po: 38.2%, Anoj nga Po: 41.8%) besojnë se SPAK është serioz në përpjekjet e tij për të çmontuar rrjetet kriminale. Vetëm **18%** shprehën skepticizëm dhe **2.0%** shprehën pasiguri. Ky nivel besimi ka të ngjarë të lidhet me hetimet e profilit të lartë të SPAK-ut, perceptimin për pavarësi nga politika dhe rolin e tij si simbol i reformës në drejtësi. Kjo tregon se qytetarët e shohin SPAK-un jo thjesht si një organ zbatues, por si një gur themeli të integritetit institucional.

A mendoni se insitucionet e mëposhtme janë serioze në luftën ndaj krimit të organizuar?




Grafik 70. Opinioni mbi seriozitetin e Qeverisë, Gjykatave të Posaçme dhe SPAK në luftën kundër krimit të organizuar

SPAK vazhdon të gëzojë besimin më të lartë publik, jo vetëm për angazhimin e tij në luftën kundër krimit të organizuar, por edhe për autonominë e perceptuar. Një total prej **60.3%** të të anketuarve (Anoj nga Jo: 37.2%, Jo: 23.1%) hedhin poshtë idenë se vendimmarrja e tij ndikohet politikisht. Megjithatë, **36.1%** shprehën shqetësim për ndërhyrje politike dhe **3.7%** shprehën pasiguri. Kjo sugjeron se SPAK shihet jo thjesht si një organ zbatues, por si një simbol i integritetit institucional.

Kur bëhet fjalë për ndikimin politik mbi Gjykatat e Posaçme, tabloja është më e përzier. Ndërsa **53.2%** e të anketuarve (Anoj nga Jo: 40.0%, Jo: 13.2%) besojnë se këto gjykata funksionojnë në mënyrë të pavarur, një përqindje e konsiderueshme – **41.3%** (Po: 11.3%, Anoj nga Po: 30.0%) – dyshojnë për një nivel të caktuar presioni politik. Ky dyzim mund të lidhet me skepticizmin publik mbi qëndrueshmërinë e vendimeve në çështjet politikisht të ndjeshme.

A mendoni se vendimarrja e SPAK dhe Gjyktave të Posaçme ndikohet nga politika?




Grafik 71. Opinioni mbi ndikimin e politikës në vendimarrjen e SPAK dhe Gjykatave të Posaçme

Një shumicë dërrmuese e të anketuarve (**90.3%**) e vlerësojnë kontributin e SPAK-ut si të rëndësishëm ose shumë të rëndësishëm, me mbi gjysmën (**50.4%**) që e identifikojnë si shumë të rëndësishëm. Ky miratim i gjerë pasqyron reputacionin gjithnjë në rritje të SPAK-ut si një institucion i besueshëm dhe i pavarur, ndoshta i forcuar nga hetimet e profilit të lartë, rreptësia prokuroriale dhe perceptimi se është i izoluar nga ndërhyrjet politike. Vetëm **9.1%** e të anketuarve e shohin kontributin e SPAK-ut si të parëndësishëm ose shumë të parëndësishëm, ndërsa vetëm **0.6%** shprehën pasiguri – duke treguar se opinioni publik nuk është vetëm mbështetës, por edhe i qëndrueshëm.

Policia e Shtetit merr një vlerësim më të përzier. Edhe pse **78.5%** e të anketuarve e vlerësojnë kontributin e saj si të rëndësishëm ose shumë të rëndësishëm, vetëm **30.1%** e konsiderojnë si shumë të rëndësishëm – **plot 20 pikë përqindjeje** më pak se SPAK. Për më tepër, **19.8%** e të anketuarve e shohin rolin e policisë si të parëndësishëm ose shumë të parëndësishëm, më shumë se dyfishi i skepticizmit të shprehur ndaj SPAK-ut. Ndërkohë, **1.7%** e të anketuarve të pavendosur tregojnë se ekziston një shkallë pasigurie ose dyzimi lidhur me efektivitetin e policisë.

Ky ndryshim në perceptimin publik mund të shpjegohet nga disa faktorë. SPAK, si organ i specializuar prokurorial, shihet si më i izoluar nga presionet e përditshme politike dhe institucionale, ndërsa Policia e Shtetit operon brenda strukturave më të gjera burokratike dhe politike, të cilat perceptohen si më të cenueshme ndaj korrupsionit, pasigurisë ose zbatimit selektiv. Për më tepër, dukshmëria e SPAK-ut në ndjekjen e çështjeve të profilit të lartë bie në kontrast

me operacionet më të përditshme dhe të shpërndara të policisë, duke e bërë ndikimin e parë më të prekshëm për publikun.




Grafik 72. Opinioni mbi kontributin e SPAK dhe Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar

Besimi publik tek reagimi institucional ndaj raportimeve për krimin e organizuar në Shqipëri nxjerr në pah një kontrast të fortë midis perceptimeve për Policinë e Shtetit dhe SPAK-un.

Të dhënat tregojnë se vetëm **12.3%** e të anketuarve i besojnë *plotësisht* Policisë së Shtetit për ndjekjen siç duhet të raportimeve për krimin e organizuar, me një shtesë prej **31.9%** që shprehin një besim të *pjesëshëm*. Kjo e çon nivelin e përgjithshëm të besimit pozitiv në **44.2%**, por ai mbetet i tejkaluar nga **51.9%** – **29.6%** me prirje negative dhe **22.3%** me mosbesim të plotë. Ky skepticizëm shumicë tregon se shumë shqiptarë e perceptojnë Policinë e Shtetit si të kompromentuar, joefektive ose të paaftë për të treguar vullnet institucional në përballjen serioze me krimin e organizuar. Ndërkohë, **4.0%** e të pasigurtëve përfaqëson një segment të vogël, por domethënës, që mund të lidhet me mungesë transparence ose me përvoja personale të kufizuara.

Në kontrast, SPAK gëzon një besim publik dukshëm më të lartë. Një total prej **76.1%** të të anketuarve – **31.4%** që u përgjigjën “Po” dhe **44.7%** që anuan pozitivisht – besojnë se SPAK do të ndiqte në mënyrë efektive denoncimet për krimin e organizuar. Vetëm **21.8%** shprehën dyshim (**14.8%*** me prirje negative, **7.0%** “Jo”), ndërsa vetëm **2.1%** shprehën pasiguri.

A keni besim që nëse denonconi një vepër penale të lidhur me krimin e organizuar, do të ndiqet siç duhet nga Policia e Shtetit dhe SPAK?




Grafik 73. Opinioni mbi ndjekjen e denoncimeve të krimit të organizuar nga Policia e Shtetit dhe SPAK

Administrata publike luan një rol thelbësor në luftën kundër krimit të organizuar, jo vetëm përmes strategjive gjithëpërfshirëse parandaluese, ndëshkuese dhe edukative, por edhe përmes **qasjes administrative**, e cila përfshin përdorimin e kompetencave të administratës publike – si revokimi i licencave, refuzimi i lejeve, etj. – për të penguar aktivitetet e grupeve kriminale.

Publiku tregon një besim të fortë në potencialin e administratës publike për të dhënë një kontribut domethënës në luftën kundër krimit të organizuar, megjithëse ky besim shoqërohet edhe me disa dyshime mbi kapacitetin ose integritetin aktual të saj. Një total prej **72.5%** të të anketuarve (**30.2%** u përgjigjën “Po” dhe **42.3%** me prirje pozitiv) shprehën besim se administrata publike mund të luajë një rol konstruktiv.

A mendoni se administrata publike mund të luajë një rol në luftën kundër krimit të organizuar?




Grafik 74. Opinioni mbi rolin e administratës publike në luftën kundër krimit të organizuar

Perceptimi publik mbi dënimet e gjykatave për krimin e organizuar nxjerr në pah një shqetësim të theksuar mbi butësinë dhe pandëshkueshmërinë. Një shifër e lartë prej **74%** të të anketuarve (30.1% thonë se *dënimet janë shumë të buta* dhe **43.9%** thonë *thjesht të buta*) besojnë se gjykatat nuk po vendosin ndëshkime mjaftueshëm të ashpra për individët e përfshirë në krimin e organizuar. Ky perceptim dominues sugjeron një zhgënjim të gjerë me paaftësinë e perceptuar të sistemit të drejtësisë për të dhënë pasoja proporcionale – gjë që potencialisht minon efektin parandalues dhe besimin publik.

Në kontrast, vetëm **22.6%** e të anketuarve mendojnë se *dënimet janë të sakta*, duke treguar se më pak se një në katër shqiptarë besojnë se gjyqësori po gjen ekuilibrin e duhur. Kjo pakicë mund të përfaqësojë ata që shohin në reformat e fundit ose në çështjet e profilit të lartë shenja përparimi, ose ata që mbështesin një qasje më rehabilituese ndaj drejtësisë.

Si mendoni se janë dënimet e dhëna nga gjykatat ndaj individëve të përfshirë në krim të organizuar?



Grafik 75. Opinioni mbi dënimet e gjykatave ndaj individëve të përfshirë në krimin e organizuar


Opinioni publik pasqyron një nivel të lartë besimi tek roli i Bashkimit Evropian dhe i Shteteve të Bashkuara në luftën kundër krimit të organizuar. Të dhënat tregojnë një mbështetje të fuqishme për të dy aktorët, me dallime të nuancuara në perceptimin e ndikimit dhe besueshmërisë së tyre.

91.3% e të anketuarve e vlerësojnë kontributin e BE-së si të rëndësishëm (**49.2%**) ose shumë të rëndësishëm (**42.1%**). Kjo shumicë dërrmuese tregon se shqiptarët e shohin BE-në jo vetëm si një pikë referimi normative për reformën ligjore dhe institucionale, por edhe si një aleat praktik në forcimin e mekanizmave të shtetit të së drejtës. Mbështetja e BE-së – përmes asistencës teknike, reformës në drejtësi dhe përafrimit me *acquis communautaire* – njihet qartësisht si instrumentale në formësimin e arkitekturës antikriminale të

Shqipërisë. Vetëm **8.6%** shprehën skepticizëm (**8.1%** e konsideruan të parëndësishme, ***0.5%** shumë të parëndësishëm) dhe një përqindje pothuajse e papërfillshme (**0.1%**) shprehu pasiguri, duke treguar se roli i BE-së është gjerësisht i kuptuar dhe i vlerësuar. Ky besim lidhet gjithashtu me aspiratën e gjerë për integrim në BE, ku krimi i organizuar shihet si një pengesë për anëtarësim dhe përfshirja e BE-së si një forcë korrigjuese.

SHBA gëzon një mbështetje edhe më të fortë, me **93.5%** të të anketuarve që e vlerësojnë kontributin e saj si të rëndësishëm (**44.2%**) ose shumë të rëndësishëm (**49.3%**). Ky nivel besimi, disi më i lartë se për BE-në, tregon se SHBA perceptohet si një aktor më i vendosur – ndoshta për shkak të mbështetjes së dukshme për SPAK-un, diplomacisë publike dhe përkrahjes për hetimet dhe ndjekjet penale të profilit të lartë. Vetëm **6.3%** shprehën dyshim (**5.8%** e konsideruan të parëndësishme, ***0.5%** shumë të parëndësishme) dhe vetëm **0.2%** shprehën pasiguri, duke forcuar idenë se SHBA shihet si një partner i besueshëm dhe i orientuar drejt rezultateve në luftën e Shqipërisë kundër krimit të organizuar.

Si e vlerësoni kontributin e BE-së dhe SHBA-se në luftën kundër krimit të organizuar?



Grafik 76. Opinioni mbi kontributin e BE-së dhe SHBA-së në luftën kundër krimit të organizuar



VIKTIMIZIMI DHE RAPORTIMI I KRIMIT

VIKTIMIZIMI DHE RAPORTIMI I KRIMIT

Anketat mbi viktimizimin dhe raportimin e krimeve janë thelbësore për të kuptuar shkallën e vërtetë të kriminalitetit dhe ndikimin e tij, pasi ato kapin të dhëna si mbi rastet e raportuara, ashtu edhe mbi ato të pareportuara. Të kuptuarit e shkallës së viktimizimit dhe gatishmërisë së individëve për të raportuar krimet është vendimtar për të vlerësuar realisht ndikimin e krimit të organizuar dhe për të zhvilluar strategji efektive për mbështetjen e viktimave dhe forcimin e përpjekjeve të zbatimit të ligjit.


Ky kapitull analizon të dhënat e anketës mbi përvojat personale të viktimizimit, normat e raportimit, arsyet e mosraportimit dhe nivelet e frikës, duke ofruar një panoramë të detajuar të sfidave me të cilat përballen qytetarët shqiptarë.

Pyetjet e parashtruara ishin:

- *A keni qenë vetë viktimë e një krimi gjatë 3 viteve të fundit?*
- *A e keni raportuar krimin e kryer ndaj jush në institucionet përkatëse? (Vetëm ata që thonë se kanë qenë viktimë e krimit)*
- *A njihni një të afërm ose mik që ka qenë viktimë e një krimi/vepre kriminale gjatë 3 viteve të fundit?*
- *A e ka raportuar ai/ajo krimin e kryer në institucionet përkatëse? (Vetëm ata që thonë se kanë të afërm/mik që ka qenë viktimë e krimit)*
- *Mendoni se qytetarët shqiptarë në përgjithësi raportojnë të gjitha krimet ku janë viktimë?*
- *Mendoni se qytetarët shqiptarë në përgjithësi raportojnë të gjitha krimet që dëshmojnë edhe kur nuk janë vetë viktimë?*
- *Nëse do të denonconit një krim, a do të kishit frikë ta raportonit?*
- *Çfarë lloj krimesh mendoni se mbeten të paraportuara?*
- *Cilat janë arsyet pse qytetarët shqiptarë nuk raportojnë krimet që dëshmojnë?*

Të dhënat tregojnë se, ndonëse viktimizimi i drejtpërdrejtë nga krimi në Shqipëri është relativisht i ulët, shkalla e raportimit është edhe më e kufizuar. Vetëm **4.4%** e të anketuarve thanë se kanë qenë personalisht viktimë të një krimi gjatë tre viteve të fundit, ndërsa **95.2%** deklaruan se nuk kishin përjetuar një rast të tillë, dhe **0.4%** refuzuan të përgjigjeshin. Këto shifra sugjerojnë se shumica e shqiptarëve nuk e përfjetojnë krimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të paktën nuk e identifikojnë veten si viktimë brenda kuadrit të anketës.

A keni qenë ju personalisht i prekur nga një ngjarje/vepër kriminale në 3 vitet e fundit?



Grafik 77. Opinioni mbi përvojën personale me ngjarje ose vepra kriminale në tre vitet e fundit

Mes atyre që deklaruan se kishin qenë viktimë, vetëm **2.9%** thanë se e kishin njoftuar institucionin përkatës, ndërsa **1.4%** pranuan se nuk e kishin bërë. Shumica dërmuese prej **95.7%** e kaluan pyetjen, pasi nuk ishin identifikuar si viktimë.

A e keni raportuar krimin ndaj jush tek institucionet përkatëse?



Grafik 78. Opinioni mbi raportimin e përvojave kriminale tek institucionet përkatëse


Vetëm **4.4%** e të anketuarve raportuan se kishin qenë personalisht viktimë të një krimi, ndërsa një përqindje dukshëm më e lartë – **13.7%** – deklaruan se njihnin një të afërm ose mik që kishte qenë viktimë e një krimi gjatë tre viteve të fundit. Kjo tregon se kriminaliteti mund të jetë më i përhapur sesa reflektojnë shifrat e viktimizimit personal dhe se ndikimi i tij shtrihet përtej individit, duke prekur rrjetet dhe strukturat më të gjera shoqërore. Nga ana tjetër, shumica

dërrmuese – **85.5%** – thanë se nuk njihnin askënd të prekur nga krimi, ndërsa **0.8%** refuzuan t'i përgjigjeshin pyetjes.




Grafik 79. Opinioni mbi përvojën e të afërmeve dhe miqve me ngjarje kriminale në tre vitet e fundit

Mes atyre që pranuan se njihnin një viktimë, vetëm **9.9%** deklaruan se rasti ishte denoncuar në institucionet përkatëse, ndërsa **3.0%** deklaruan se nuk ishte raportuar. Një shumicë e konsiderueshme prej **86.4%** e kaluan pyetjen, pasi nuk kishin identifikuar askënd të prekur nga krimi. Këto të dhëna pasqyrojnë të njëjtin trend të vërejtur më parë: edhe kur krimi prek rrethin shoqëror të individit, raportimi formal mbetet i kufizuar.




Grafik 80. Opinioni mbi raportimin e ngjarjeve kriminale nga të afërmit ose miqtë tek institucionet përkatëse

Kur u pyetën nëse qytetarët shqiptarë në përgjithësi raportojnë krimet ku janë viktimat, vetëm **15.1%** u përgjigjën me një “Po” të sigurt, ndërsa një pjesë më e madhe – **35.8%** – shprehën një prirje pozitive. Megjithatë, pothuajse një përqindje e ngjashme shprehu skepticizëm: **31.6%** anuan drejt “Jo” dhe **14.1%** u shprehën me bindje se viktimat nuk i raportojnë krimet. Pjesa e mbetur, **3.3%**, e të anketuarve shprehën pasiguri.



Grafik 81. Opinioni mbi perceptimin mbi raportimin e krimeve nga qytetarët shqiptarë


Pamja bëhet edhe më shqetësuese kur pyetja zhvendoset tek krimet e dëshmuara, e jo ato të përjetuara personalisht. Vetëm **4.4%** e të anketuarve besojnë se qytetarët i raportojnë rregullisht krimet që shohin, ndërsa **17.5%** anonin drejt këtij mendimi. Në kontrast, një shumicë dërrmuese prej **73.5%** ose anuan drejt “Jo” (**43.2%**), ose shprehën hapur “Jo” (**30.3%**), ndërsa **4.7%** shprehën pasiguri. Kjo rënie e ndjeshme në perceptimin e raportimit tregon se shqiptarët janë dukshëm më mosbesues për gjasat që dëshmitarët të paraqiten përpara autoriteteve — ndoshta për shkak të frikës nga hakmarria, stigmës shoqërore, ose mungesës së besimit tek institucionet për ndjekjen e rasteve.



Grafik 82. Opinioni mbi raportimin e krimeve nga qytetarët shqiptarë edhe kur nuk preken drejtpërdrejt


Një përqindje e lartë prej **57.1%** e të anketuarve thanë se do të kishin frikë të raportonin apo denonconin një krim. Kjo shumicë tregon se frika – qoftë nga hakmarrja, stigma shoqërore, mosveprimi institucional apo ekspozimi personal – është një faktor dominues që formëson sjelljen publike. Vetëm **29.8%** e të anketuarve deklaruan se nuk do të kishin frikë të raportonin një krim, duke treguar se më pak se një e treta e popullsisë ndihet e sigurt ose e fuqizuar për t'u angazhuar me organet e rendit apo institucionet gjyqësore. Ndërkohë, **12.9%** ishin të pasigurt dhe **0.3%** refuzuan të përgjigjeshin – shifra të vogla, por domethënëse, që pasqyrojnë pasiguri dhe ndoshta siklet ndaj vetë temës.

Këto përgjigje zbulojnë një ndjenjë të thellë frike dhe hezitimi lidhur me aktin e raportimit të krimit në Shqipëri.




Grafik 83. Perceptimi i frikës nga denoncimi i një ngjarjeje penale/krimi

Kur u pyetën se çfarë lloj krimesh prirën të mbeten të pareportuara, të anketuarit theksuan në mënyrë dërrmuese ato që lidhen me pushtetin e autorëve dhe dobësinë e viktimave. Më shpesh u përmendën: **krimet e kryera nga kriminelë me ndikim (36.4%), dhuna në familje (25.3%) dhe krimet e kryera nga zyrtarë shtetërorë (24.7%)**. Në kontrast, vetëm **11.8%** menduan se vjedhjet e vogla mbeten të pareportuara, duke treguar se krimet e përditshme ka më shumë gjasa të raportohen, ndërsa ato sistemike ose të ndjeshme mbeten të fshehura.



Grafik 84. Perceptimi i llojeve të krimeve që raportohen më pak

Shkaqet e kësaj heshtjeje janë po aq domethënëse. Faktori më dominues është **frika nga hakmarrja**, të cilën e përmendin **56.2%** e të anketuarve. Kjo frikë – qoftë fizike, shoqërore apo profesionale – pasqyron rreziqet që shumë shqiptarë i lidhin me raportimin e krimit, sidomos kur autorët kanë ndikim ose veprojnë brenda rrjeteve të mbyllura. Një tjetër përqindje e konsiderueshme, **29.5%**, tregojnë **mungesë besimi se autoritetet do të ndjekin rastin**, duke reflektuar skepticizmin e thellë ndaj reagimit dhe efektivitetit institucional. Ky qëndrim përputhet me gjetjet e mëparshme mbi normat e ulëta të raportimit dhe perceptimin e ngadalësisë institucionale. Një përqindje më e vogël, por domethënëse (**12.0%**), thekson se qytetarët shpesh **nuk e identifikojnë juridikisht një ngjarje si krim**, çka tregon boshllëqe në njohuritë ligjore dhe kuptimin publik se çfarë përbën një vepër të denoncueshme. Ky aspekt bëhet veçanërisht i rëndësishëm në rastet e dhunës në familje apo korrupsionit, ku normat kulturore ose kufijtë e paqartë e zbehin dallimin mes të ligjshmes dhe të paligjshmes.



Grafik 85. Perceptimi i arsyeve pse qytetarët shqiptarë nuk denoncojnë krimet e konstatuara personalisht

Përgjigjet ndaj pyetjeve mbi viktimizimin dhe raportimin e krimeve nxjerrin në pah një kontradiktë të vazhdueshme mes përvojës ndaj krimit, përgjegjësisë qytetare dhe besimit tek institucionet në Shqipëri. Në pamje të parë, krimi duket se është një përvojë personale relativisht e rrallë, por afërsia e tij sociale përmes miqve dhe familjarëve është më e dukshme. Kjo dualitet sugjeron se, ndonëse individët nuk e përballin shpesh drejtpërdrejt krimin, prania e tij ndihet dhe vërehet brenda komuniteteve.

Megjithatë, ky ndërgjegjësim nuk përkthehet në veprim. Sjellja e raportimit mbetet vazhdimisht e ulët, si mes viktimave, ashtu edhe mes dëshmitarëve, duke treguar një hezitim të gjerë për t'u angazhuar me mekanizmat formalë të


drejtësisë. Ky hezitim nuk duket të lidhet me apatinë, por më shumë me një ndërthurje të frikës, skepticizmit dhe perceptimit të mungesës së shpresës.

Në një analizë më të thelluar, të dhënat tregojnë për një mjedis qytetar të formësuar nga asimetritë e pushtetit dhe dobësia institucionale. Krimet që përfshijnë aktorë me ndikim – qoftë rrjete kriminale, zyrtarë qeveritarë apo brenda sferës familjare – perceptohen si krime që shpesh mbeten të padeklaruar/pa u raportuar.

Reagimi emocional mbizotërues ndaj idesë së raportimit është frika, e shoqëruar nga mungesa e besimit tek ndjekja institucionale. Kjo pasqyron jo vetëm një krizë të zbatimit të ligjit, por edhe një krizë legjitimiteti, duke paraqitur një panoramë ku normat ligjore zbatohen në mënyrë të pabarabartë dhe ku të flasësh hapur mund të mbart rrezik personal.

Si pasojë, krijohet një kulturë qytetare e karakterizuar nga kujdesi i tepruar, fragmentimi dhe angazhimi selektiv, që kërkon një ndërhyrje jo vetëm përmes reformës ligjore, por edhe përmes një veprimi të përbashkët për të rimenduar besimin publik, mbrojtjen dhe fuqizimin qytetar.

Shtojca 1 – Shpërndarja gjeografike



Shtojca 2 – Shpërndarja sipas bashkive

Bashkitë ku janë kryer intervistat

Bashkia	%
1.Belsh	0.5
2.Berat	2.0
3.Bulqizë	0.9
4.Cërrik	0.8
5.Delvinë	0.2
6.Devoll	1.1
7.Dibër	1.8
8.Divjakë	1.3
9.Dropull	0.4
10.Durrës	6.6
11.Elbasan	4.8
12.Fier	4.8
13.Finiq	0.4
14.Fushë-Arrëz	0.2
15.Gjirokastrë	1.1
16.Gramsh	0.8
17.Has	0.2
18.Himarë	0.4
19.Kamëz	3.7
20.Kavajë	1.8
21.Këlcyrë	0.2
22.Klos	0.5
23.Kolonjë	0.4
24.Konispol	0.1
25.Korçë	2.7
26.Krujë	2.2
27.Kuçovë	1.2
28.Kukës	1.2
29.Kurbin	1.5

30.Lezhë	2.5
31.Libohovë	0.1
32.Librazhd	0.9
33.Lushnje	2.9
34.Malësi e Madhe	1.1
35.Maliq	1.4
36.Mallakastër	1.1
37.Mat	0.8
38.Memaliaj	0.3
39.Mirditë	0.8
40.Patos	1.1
41.Peqin	0.8
42.Përmet	0.3
43.Pogradec	2.1
44.Poliçan	0.3
45.Prenjas	0.6
46.Pukë	0.4
47.Pustec	0.2
48.Roskovec	0.6
49.Rrogozhinë	1.0
50.Sarandë	0.9
51.Selenicë	0.5
52.Shijak	1.1
53.Shkodër	4.0
54.Skrapar	0.3
55.Tepelenë	0.4
56.Tiranë	22.6
57.Tropojë	1.3
58.Dimal	0.7
59.Vau i Dejës	1.0
60.Vlorë	3.3
61.Vorë	1.2

Qarqet ku janë kryer intervistat

	%
1.Berat	4.7
2.Dibër	3.8
3.Durrës	9.7
4.Elbasan	9.2
5.Fier	11.7
6.Gjirokastrë	2.8
7.Korçë	8.0
8.Kukës	2.5
9.Lezhë	4.8
10.Shkodër	6.9
11.Tiranë	30.0
12.Vlorë	6.0

BAROMETRI I SIGURISË SHQIPËRI ANKETË KOMBËTARE